



RAPORT I MBAJTUR NGA SHOKU HYSNI MILLOSHI NË EMËR TË KOMITETIT QËNDROR TË PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË NË KONGRESIN E 14-TË TË SAJ

Shokë e shoqe,

Ky Kongres koinçidon me 70 vjetorin e Themelimit të Partisë Komuniste Shqiptare. Kur Partia të mbushë 100 vjeç, ne, me siguri në një sallë më të madhe se kjo dhe me një forcë dhe entuziazëm qindrafish më të madh se ky i sotmi do të mblihdemi në Kongresin e radhës dhe, ashtu si sot, do t'u bëjmë një homazh komunistëve të parë shqiptarë që, nën udhëheqjen e Enver Hoxhës, fituan ndër beteja dhe shpëtuan vetë ekzistencës kombëtare, duke i dhënë nder e lavdi Atdheut tonë të martirizuar.

Ne jemi këtu si marksistë-leninistë të së vërtetës, që mbrojmë me vetëdije idealet komuniste, historinë e Partisë Komuniste në luftën për çlirim kombëtar e shoqëror, si dhe të gjitha ato fitore madhështore që u arritën në socializëm, pa lënë në harresë as çdo të mëtë e dobësi që mund të shihet sot pas një refleksioni të urtë për atë udhë të gjatë e të pashkelur, sa të mundimëshme aq edhe të lavdishme. **Kush mohon fitoret është kriminel, kush mohon të metat në rrugën e fitoreve nuk është marksist.**

Socializmi si sistem botëror më vete u përmbys de jure para 20 vjetësh. De fakto rrënjët e tragjedisë komuniste janë shumë më të herëshme. Socializmi në Bashkimin Sovjetik dhe në krejt Europën Lindore, pra kalimi nga një sistem në një tjetër, **për herë të parë në historinë njerëzore u krye pa luftë, sepse, me thënë të vërtetën, këtë kalim e bënë vetë komunistët që kishin pushtetin.** Ky fenomen i njohur për herë të parë në historinë e njerëzimit domosdo kërkon analizë prej mendjesh të ndritura, që, me siguri, nuk do t'i mungojnë lëvizjes komuniste botërore.

Ne vijmë tashmë në këtë kongres si luftëtarë të rezistencës kundër kapitalizmit e të gjitha krimeve që burojnë prej tij me ëndrrën e madhe që në Jubiletë e ardhshëm të hyjmë si fitimtarë dhe duke kënduar Internacionalen, siç e kënduan themeluesit e parë më 8 Nëntor 1941.

Ne ndihemi krenarë që jemi pasardhës të atyre burrave të mëdhenj që bënë epokë dhe përpiqemi të ecim në gjurmët e tyre. Ne ndihemi krenarë në mënyrë të veçantë për figurën e ndritur të shokut Enver Hoxha si udhëheqës gjysmë shekullor i Shqipërisë. Sulmi frontal i borgjezisë së re shqiptare për të kriminalizuar jetën dhe veprën e tij është në thelb sa antihistorik aq edhe antikombëtar, prandaj qysh sot mund të llogaritet i dështuar. Enver Hoxha pati rol përcaktues e të pazëvendësueshëm në luftën e madhe për liri e socializëm.

Kontributet e tij janë të pashembullta. **Lavdia e tij u ngjan oqeanëve, hapësirën e të cilëve nuk mund ta matësh me sy as nga brigjet e tyre e as nga avionët duke fluturuar mbi ta.**

Që prej 20 vjetësh komunistët shqiptarë me guxim e dashuri legjendare kanë hedhur e do të hedhin poshtë me neveri të gjitha insinuatat e krijuara kundër tij dhe e kanë konsideruar inkuzicionin ndaj Enver Hoxhës si thikë kriminale në kurriz të vetë popullit shqiptar e kombit shqiptar. **Enver Hoxha ishte një gjeni dhe mbi gjenitë, ashtu si mbi Prometeun, bie zemërimi i tiranëve dhe, kur nuk munden dot to gjallë, armata e plehrave të historisë, sulmon t'i mundë të vdekur, po ndërkaq lavdia e gjenive çan kohërat e reve të zeza, del në dritë të diellit e rron në të ardhmen. Më shumë se e shkuar Enver Hoxha është e ardhme.**

Para disa kohësh, në një emision televiziv, një gazetar i njohur tha se **“ne e dinim që komunizmi kishte vdekur, por ai qenka gjallë dhe mu brenda në Tiranë”**. Gazetari është i ri në moshë dhe ka mjaft vite përpara të mësojë e të bindet se komunizmi si ideal mund të vdesë vetëm po të vdiste shpirti i së ardhmes së popujve e të ndodhte ndonjë apokalips. Ky gazetar ka qenë fort i ri para 20 vjetësh kur e tërë bota kapitaliste tha se “Marksi vdiq”. Mirëpo sot e tërë bota lëngon e tmerruar në krizë. Një tufan protestash kanë shpërthyer në qytetet e Amerikës e të Europës, janë shtrirë gjer në Japoni e po duken edhe në Kinë dhe Marksi, babai i doktrinës komuniste, ndodhet më shumë se kurrë pranë popujve. Në ndonjë emision të ardhshëm televiziv nuk do të jetë çudi që gazetari të jetë i detyruar të thotë: **“Paska qenë rrenë ajo që na u tha 20 vjet më parë se Marksi vdiq. Ja që Marksi qenka gjallë, Marksi po vjen”**.

Kur plasi kriza financiare në Bankat e Uoll Stritit dy-tri vjet më parë, pikërisht para të cilave protestojnë sot mijëra amerikanë dhe thonë me zë të lartë se **“ne përfaqësojmë 98 për qind të popullsisë amerikane”**, Marksi u shfaq në horizont me parashikimin e tij gjenial që kishte bërë gati një shekull e gjysëm më parë se: **“Pronarët e kapitalit do ta stimulojnë klasën punëtore gjithnjë e më shumë me mallra të shtrenjta, shtëpi dhe teknologji, duke i shtyrë të marrin gjithnjë e më shumë kredi të larta, deri në atë pikë sa borxhi i tyre të bëhet i papërballueshëm. Borxhi i papaguar do t'i shtyjë bankat drejt falimentimit, të cilat paskëtaj duhet të shtetëzohen, ndërsa shetit do t'i duhet të ndërmarrë një rrugë që eventualisht do të shpjerë në komunizëm”**.

Dhe a nuk ndodhi kështu? A nuk dëgjuam ekonomistë kapitalistë që thanë: “Mos po del realisht e vërtetë profecia e Marksit? A nuk pati kryeministra të sheteve më të fuqishëm kapitalistë që e ngritën edhe çështjen e shtetëzimit të bankave? Sigurisht pati. Kriza, si një murtajë, ka përfshirë mbarë botën. Sot nuk bëhet fjalë vetëm për falimentimin e disa bankave. Sot bëhet fjalë deri për rrezik falimentimi shtetesh si Greqia fqinje, sot bëhet fjalë për rrezikun e falimentimit të Eurozonës. Sot Europa, kontinenti i vjetër, që është konsideruar si qendra e botës, është në alarm dhe u bie sirenave që paralajmërojnë rrezik vdekjeje. Sot bëhet fjalë për falimentim të Europës së Bashkuar e falimentimin e kapitalizmit. Kriza greke në fakt është edhe krizë europiane. Më tepër se kaq, ajo është krizë botërore. Greqia hyri në Europën e 17 shteteve me mashtime financiare. Dhe kjo u diktua kur falimentoj një bankë amerikane me të cilën ishte e lidhur qeveria greke. Ndërkaq borxhi publik i saj ishte 350 miliard Euro. Plasi tollumbacja e madhe dhe në horizont u duk edhe rreziku i plasjes së tollumbaces Eurozonë. E po të ndodhte kjo, domethënë Greqia të dilte nga Eurozona, do të niste edhe shembja e Bashkimit European, prandaj Europa i ka rënë në gjunjë Gjermanisë, roli i së cilës në këto momente është i pazëvendësueshëm për shpëtimin si të Eurozonës, si të Bashkimit European.

Mbarë bota kapitaliste përjeton tmerr e frikë. Rimëkëmbja e ekonomisë amerikane sipas vetë Barak Obamës është e brishtë dhe e ngadaltë. Flitet për rikapitalizim të bankave, flitet për një kapitalizëm të ri, për një rend të ri botëror, për një modifikim kapitalist e të tjera përralla. Po ç'mund t'i modifikosh një mumje të Egjiptit? Modifikoje sa të duash, mumja e vdekur nuk ngjallet më. Kapitalizmi plak është më shumë se kurrë pranë vdekjes.

Jo shumë larg mbi rruzullin tokësor jetonin vetëm një miliard e pesëqind milionë njerëz. Sot vetëm Kina ka një miliard e pesëqind milionë njerëz. Sot mbi rruzullin tokësor jetojnë shtatë miliard njerëz. Ndërkaq vetëm një grusht i vogël kapitalistësh kanë në duar mbi 80 për qind të të gjitha pasurive të njerëzimit, që, sipas llogarisë, del se shtatë miliardët kanë në duar vetëm 20 për qind të pasurive.

Nga një polarizim supergjigand i shoqërisë njerëzore një mendje e vobegte mund të mendojë se fitorja e njerëzimit të madh mund të arrihet brenda pak ditësh. Jo, as kjo nuk është e vërtetë. Duke parë fundin e vet, kapitalizmi, për të shpëtuar lëkurën, do të kërkojë rrugë e shtigje për t'i zgjatur ditët. Perandoria kapitaliste, e zhytur për vdekje në krizë, do të mobilizojë të gjitha potencialet, të gjitha rezervat financiare që ka grumbulluar me djersën dhe gjakun e popujve, gjithë solidaritetin, gjithë armët e propagandës dhe bazat ushtarake të zjarrit për të qëndruar në këmbë. Siç thotë një shkrimtar i famshëm gjerman i ditëve tona, Hans Magnus Enzensberger, **”kapitalizmi di të martohet me gjithçka, si me demokracinë, ashtu edhe me diktaturën, si me fashizmin, ashtu edhe me një parti kineze që e përkufizon veten komuniste”**.

Nisur nga kjo e vërtetë tingëllonjë më bukur se kurrë thirrja madhështore e Marksit “Proletarë të të gjitha vendeve bashkohuni” dhe ajo e Enver Hoxhës “Çështja e revolucionit është e shtruar për zgjidhje”. Kapitalizmi plak nuk duhet lënë të martohet më, sepse çdo martesë e re kapitaliste do të ishte mort për njerëzimin. Para njëzet vjetësh borgjezia europiane hapi dyert e ambasadave në Shqipëri dhe e priti me entuziazëm përmbysjen e socializmit, po sot çfarë dyersh do të hapë për të shpëtuar vetveten nga kriza në Greqi, Portugali, Itali, Spanjë? Jo bashkim qeverish e bankash për të shpëtuar borgjezinë nga kriza, por bashkim popujsh për të përmbysur borgjezinë që prodhon kriza! Kjo duhet të jetë motoja e sotme, sepse kjo që po ndodh është kriza tipike kapitaliste, krizë që buron nga vetë sistemi, jo thjeshtë nga borxhet. Me një ekonomi në ngjitje borxhet mund të paguhen, ndërsa me një ekonomi në rënie e në rrënim, nuk mund të paguhen dhe vjen pastaj falimentimi. **Para 20 vjetësh u duk se mbi 500 mijë shqiptarë gjetën paraajsën në Greqi, por sot shihet qartë drama e falimentimit të ekonomisë greke. Kjo dramë nuk rëndon vetëm mbi popullin grek, por edhe mbi emigrantët shqiptarë.** Në këtë situatë Karaxhaferët e Greqisë mund të sulmojnë emigrantët shqiptarë. Ka ardhur koha për përlëshje klasore me borgjezinë në të gjitha vendet, që populli të ndërjegjësohet ta përmbysë atë dhe të marrë pushtetin.

Flitet sot për pranvera të ndryshme, siç ishte kjo e fundit, e ashtuquajtura “pranvera arabe”. Natyrisht revoltat e popujve për kundër shfrytëzimit kapitalist e diktaturave borgjeze për një jetë më të mirë duhen konsideruar pozitive, por, megjithatë, **nuk sjellin shumë pranverë ato lëvizje që menaxhohen e mbështeten nga fuqitë më të egra kapitaliste.** Me farën shterpë të mbjelljes gjoja të pranverës së demokracisë në këto vende, në fakt imperialistët ndërmarrin betejat e tyre strategjike për të fituar lëndë të parë e ndarë plaçkën e luftës.

Në Libi, për shembull, gjaku i Moamar Gadafit u derdh së pari që në fuqitë e Amerikës apo Francës të derdhej naftë. Ka më shumë interes të vendoset gjoja “demokracia” ku ka naftë se sa në një vend komunist si Koreja e Veriut, por që s'ka naftë. Këto vitet e fundit është folur

edhe për pranverë të demokratice në Irak e Afganistan, megjithatë sytë e mbarë njerëzimit nuk panë të mbinte ndonjë lule në këto vende, por panë se u vranë rreth 150 mijë njerëz. E kjo s'mund të quhet ndryshe veçse pranverë me lule varresh. **Ndërkaq s'po duket në horizont, për shembull, ndonjë pranverë palestineze, me popullin martir të të cilit izraelitët e sotëm po sillen pak a shumë si nazistët e djeshëm me izraelitët e djeshëm. Partia Komuniste e Shqipërisë rikonfirmon qëndrimin e saj parimor konsekuent në dhjetra vjeçarë se qëndron në mbështetje të popullit palestinez. Ajo deklaron se është në turpin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara që nuk i jep të drejtën e shtetit këtij populli të lashtë.** PKSH gjithashtu paralajmëron se kjo krizë e madhe që ka mbërthyer botën mund të çojë jo vetëm në luftë lokale, por edhe më gjerë. Reja e zezë e luftës nuk varet sot vetëm mbi Iran.

Në këtë situatë që ndodhet bota lëvizja komuniste ndërkombëtare ka detyrat e saj, Partia Komuniste Shqiptare ka të vetat. Zbatimi i tyre në xhunglën e mafies që ka mbuluar vendin, si në asnjë cep të Europës, do të kërkonte në fakt sakrificë sublimë titanësh revolucionarë. Është e ndershme ta themi hapur e me urtësinë shqiptare se është në dorën e këtij Kongresi pozitiviteti ynë në të nesërmen. **Këtij Kongresi i takon të jetë kapiteni i anijes, i cili matë lartësinë e dallgëve mbi det, e parashikon ajsbergët e mundshëm nën det dhe përcakton drejtimin e manovrat për ta nxjerrë anijen faqebardhë në liman.**

Ashtu si dielli që duket në mëngjes, ashtu dhe në këtë kuvend të shkurtër luftarak do të duket se sa të obliguar e të betuar jemi për të shënuar një kthesë të fortë, shumë të fortë revolucionare, që të ndihemi me të vërtetë fuqishëm si një **faktor politik**, gjithëmonë duke ruajtur si gjënë më të shtrenjtë identitetin si Parti me të vërtetë komuniste e marksiste-leniniste, në aleancë me fakirfukaranë e në një luftë të pakompromis me tërë reaksionin e tërbuar antikomunist, me "tërë paçavurat që zunë myk ndër tempuj", me tërë ata që na reklamohen si engjëj të demokracisë, por që janë djaj, duke mos bërë as gabimin fatal për t'i ndarë djajt në djaj të zinj e djaj të bardhë. **Djalli s'ka ngjyrë. 20 vjet kanë qenë plot për të mësuar se djalli është djall, pavarësishtë me çfarë ngjyre e ka këmishën. Edhe gjarpërinjtë ndryshojnë nga këmishat, por helmin e kanë të njëjlojtë vdekjeprurës.**

Kur 70 vjet më parë rreth 200 komunistë u mblodhën të themelojnë Partinë Komuniste vendosën më në fund që ajo të quhej Partia Komuniste Shqiptare dhe jo e Shqipërisë, se komunistët e asaj kohe patën një ëndërr: të ishte Parti në shërbim të gjithë shqiptarëve, pra këtej e përtej kufijve shtetërorë. Se edhe 15 delegatët vinin nga e tërë hapësira kombëtare, prej të cilëve katër ishin kosovarë, katër korçarë, një dibran në origjinë, një kolonjar, dy shkodranë, një vlonjat dhe një gjirokastrit. Por ky numër ka pak rëndësi. Ajo çka është e rëndësishme, Partia u betua se do të ishte në shërbim të gjithë shqiptarëve dhe se ajo do të kishte në plan të parë çlirimin kombëtar po edhe bashkimin kombëtar në bazë të parimit universal të vëtvëndosjes deri në shkëputje, parim që pranohej qysh në fillim të shekullit si nga kapitalisti Uillson, si nga antikapitalisti Lenin. Komunistët këtej kufijve dolën me gazetën "Zëri i Popullit", po dhe komunistët përtej kufijve, në Kosovë, dolën po me gazetën "Zani i Popullit". Parti tjetër komuniste nuk u krijua në trevat jashtë kufijve shtetërore. Se si rrodhën ngjarjet e pabesitë më vonë, dihet. Kanë kaluar shtatëdhjetë vjet, por ëndrra e komunistëve të vërtetë ka mbetur zgjidhja e çështjes kombëtare, e cila edhe sot e kësaj dite ka mbetur çështje e shtruar për zgjidhje. Po hymë në vitin e 100 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë kombëtare, po njëherësh edhe në 100 vjetorin e copëtimit të Shqipërisë nga fuqitë e mëdha imperialiste, copëtim makabër që populli ynë nuk e ka pranuar kurrë.

Aty nga fund i viteve tetëdhjetë pati një shans që çështja kombëtare, makar pjesërisht, të zgjidhej. Por kur ish republikat jugosllave, që s'patën bërë asnjë orë luftë për të dalë të pavarura, sulltanët e Prishtinës e tradhëtuan popullin martir të Kosovës që kishte bërë 100 vjet luftë për bashkim me mëmëdheun dhe e vunë në gjumë duke i kënduar "Nina-Nanën": "Bëj o popull gjumë ylberi / Se liria zbret nga qielli". Shteti shqiptar nga ana e tij, i cili administronte ende një ushtri gjigande, ndërtuar nga një komandant gjigand, Enver Hoxha, prej së cilës mund të ndodheshin brënda 3-4 orësh në llogore rreth një milion ushtarë, nuk u ndodh në lartësinë e detyrës kombëtare. Kosova u ngrit pjesërisht në luftë për liri e pavarësi vetëm kur u shkatërrua ushtria gjigande shqiptare dhe ish ministri i mbrojtjes i vitit të zi 1997 deklaroi se "**dosjet e zeza të shkatërrimit të Ushtrisë nuk do të hapeshin kurrë**".

Nëse më 8 Nëntor 1941 PKSH u krijua si Parti në interes të gjithë shqiptarëve, edhe sot, pas 70 vjetësh, e tillë mbetet. Fill pas kongresit të 13-të, brenda vitit, më 23 Nëntor 2002, PKSH organizoi me 750 delegatë një kongres të posaçëm në Vlorë kushtuar çështjes kombëtare. Dokumentet kryesore të atij kongresi janë të botuara. Është koha ajo që mund të tregojë për drejtësinë e tyre. Edhe sot e kësaj dite ne, komunistët shqiptarë, jemi plotësisht të vetëdijeshëm që të japim kontributin tonë për të gjithë shqiptarët, sepse ka rënë vërtet Muri i Berlinit, por kombi ynë ka mbetur i ndarë në disa shtete e me disa mure, ku më i përfoluri e më i përgjakuri mbetet Muri i Mitrovicës. Për fat të keq zëri i komunistëve për shkak të antikomunizmit dhe të injorancës dëgjohet pak, por ne, mëgjithatë, bëjmë atë që na takon.

Por që forca jonë politike të kthehet shpresë e gjithë shqiptarëve duhen prova. Prova të mëdha. Kombi ka nevojë për dritë. E që të japësh dritë duhet të digjesh si qiriri. **Sepse qiriri bën dritë vetëm duke u djegur.** Që të japësh prova të mëdha, heroike, në radhë të parë duhet të forcosh vetveten. Pa qenë i fortë të ha miu si një kokërr gruri. Është në dorën tonë që të mos na hajë miu, por, përkundrazi, të dridhen e të futen nëpër skutat më të errta minjtë e hambarëve të borgjezisë, ata që ngrenë për ditë e më tepër kurpuse të tëra mullarësh me parà, ata që notojnë ndër pallate e ndër vila pa fund, ata që me Pandorën e korrupsionit kanë siguruar pasuri përrallore për shtatëdhjetë breza.

Është në dorën tonë dhe vetëm në dorën tonë që, duke bashkuar në një të vetme mendjet dhe zemrat, solidaritetin në unitet të çeliktë, të bëjmë sakrificat më sublime që mund të ketë parë ndonjëherë historia kombëtare dhe e gjithë bota ta marrë vesh se diku në brigjet Ballkanit një grusht komunistësh shqiptarë po luftojnë sup më sup bashkuar, në një terren krejt të hapur e pa mbrojtje, siç luftonin Pesë Heronjtë e Vigut në atë gusht me vapë të përgjakur kur:

Ushton Vigu, gur e zallë,
S'lidhen burrat për gjallë
S'lidhet Ndoçi me gjithë shokë,
Për pa vdekë, për pa mbarue
N'vënd Partisë fjalën me i çue
Ta marrë vesh Shqipnia mbarë
Mark Gjon e kumandarë
Se luftëtarët e Lirisë
Lidhë me fjalën e Partisë
S'i tremb pushka, as s'i tremb deka
Plumbja ata kur po i preka
Nëpër mish e gjak s'po veka
Porse një depo plot haska

Shumë barot mbrenë ajo paska
Vajmedet aty ku plaska.

Sikurse dihet, rreth shtatëdhjetë vjet më parë, të Pesë Heronjtë komunistë u ndodhën të rrethuar nga afro pesëqind bashibozukë të komanduar nga Pjetër Lleshi sipas urdhërit të marrë nga Gjon Marka Gjoni. **Ata vendosën të vdesin e të mos dorëzohen.** Se ata vërtetë ishin vetëm pesë përballë pesëqindëve, por ishin pesë komunistë shqiptarë, shumë të fortë, miliona fish më të fortë se armata gati pesëqindmijëshe e gjeneralit Pauls që u dorëzua e tëra para Stalingradit. Pjetër Lleshi i vrau, por Partia e komunistëve shqiptarë i ngriti për 50 vjet në pedestalin e nderit, sikundër e meritonin. Vrasja e parë Heronjve u jep pavdekësinë, kështu që ata shëtitnin nëpër Shqipëri, ishin të pranishëm në dasma e gëzime, në mort e hidhërimi, shkonin çdo 28 Nëntor në Sheshin e Flamurit në Vlorë e vinin në çdo 29 Nëntor të takonin Enver Hoxhën në Tiranë. Por Enver Hoxha vdiq dhe, siç e pamë, u ngjall menjëherë Pjetër Lleshi. U ngjall e u bë Bashki në Shkodër. Mirëpo pesë Heronjtë qëndronin ende në mes të Shkodrës në monument. Atëherë Bashkia “Pjetër Lleshi” vendosi t’i rrethojë e t’i vrasë prapë. Dhe i vrau 5 Heronjtë për të dytën herë.

Sikur e keqja të ishte vetëm kaq, të 5 Heronjtë e Vigut do ta falnin gjakun e dytë e do të na luteshin ta falnim Shkodrën. Por e keqja nuk është vetëm kaq. **Kur një kombi i vritën të pavdekshmit kjo paralajmëron vdekjen me turp të vetë kombit.** Për më tepër, e thënë më shqip, sot nuk shtrohet vetëm çështja e vrasjes dhe rivrasjes së Pesë Heronjve, por e vrasjes dhe shkatërrimit të një historie 50 vjeçare, gjë që jo vetëm e çon kombin në katastrofë, por edhe në një katastrofë më turp. Kundër këtij turpi sot për sot s’ka kush të ngrihet tjetër veç komunistëve.

Sikurse e dini, **për njëzet vjet me radhë kazma mizore e padrejtësisë ka gërmuar thellë e më thellë të shkullë rrënjët e historisë nga 8 Nëntori i vitit 1941 deri më 8 Nëntor 1991, pra plot 50 vjet histori.** Për 20 vjet me radhë, më shumë se dy fjalët “nënë dhe babë”, kanë dëgjuar dy fjalët “krimet e komunizmit” për studimin e të cilave me inisiativën e Partisë Socialiste u krijua edhe një institut i veçantë, i quajtur Institut i të Përndjekurve Politikë. Këto të ashtuquajtura “krime të komunizmit” një delegacion i parlamentit shqiptar, i përbërë nga blloku i Partisë Demokratike dhe blloku i Partisë Socialiste i pranuan si të qena më 23 Janar 2006 në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës. Pikërisht në mëngjesin e 23 Janarit 2006, vetëm disa orë përpara se të fillonte punimet Asambleja, gazeta e Partisë Komuniste të Shqipërisë, që mban emrin më të bukur në botë “Zëri i së vërtetës” doli me gërma të kuqe fund e krye me titulin “Të vërtetën mbi komunizmin dhe luftën e popujve për liri e demokraci nuk mund ta kriminalizojnë Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës”. Si asnjëherë tjetër në 20 vjet kjo gazetë u shit brenda orës. Ndërsa në Asamble u shit delegacioni shqiptar, që unanimisht ngriti dorën pro rezolutës, në një kohë kur pati debat të madh dhe një parlamentar suedez arriti të deklarojë në Asamble se **“antikomunisti është një kafshë e çuditshme që pretendon se është mik i demokracisë”**. Ndërkaq komunistët grekë deklaruan me të drejtë: **”Të gjitha krimet kundër humanizmit kanë qenë bërë në emër të “rezikut komunist” dhe se “Projektrezoluta antikomuniste është shpallje lufte kundër klasës punëtore”**. Delegacioni shqiptar i përbërë nga socialistë e demokratë, duke e miratuar Projektrezolutën antikomuniste, i konfirmuan botës se shteti shqiptar i shpallë luftë popullit të vet.

Nga tribuna e këtij Kongresi ne, komunistët shqiptarë, deklarojmë botërisht se për 20 vjet me radhë qeveritë që kanë ardhur në fuqi, të djathta a të majta, kush më shumë e kush më pak,

kanë provokuar historinë, krejt ata bij dhe bija heroike që e shkruan atë me gjak të kuq e djersë të artë në 50 vjet dhe se ne, komunistët, s'na mbetet gjë tjetër për të thënë veçse t'i shpallim këto vite si vite të krimeve të kapitalizmit.

Ndër krimet e shumta të njëzet vjetëve krimi më i poshtër e më i shëmtuar ka qenë e mbetet krimi kundër Luftës Nacionalçlirimtare, e cila është quajtur deri luftë civile. Ish kolaboracionistët, ata që bashkuan armët e zemrat me nazifashizmin pushtues, apo ata që ngritën armët kundër pushtetit popullor e vranë bijtë e popullit, ata që në këto 20 vjet kanë rrëzuar si cuba të errësirës bustet e Heronjve të Popullit, që nga Bardhok Biba në Mirditë e gjer tek Gjon Doçi në Mallakastër, ata që dje e sot kërkojnë pronat dhe dëmshpërblimet e viteve të burgut, **nëser, si të mbarojnë punë me këto, do të kërkojnë gjakun tonë, kokën tonë.** Për të demaskuar krimin më të madh të shekullit e parandaluar zgjerimin katastrofik të këtij krimi, i pari aksion i shenjtë që duhet të organizojë udhëheqja e re që do të dalë nga ky Kongres do të ishte organizimi i një manifestimi popullor në njërën nga krahinat e Atdheut tonë, ndoshta në Mallakastër, ndoshta në Sheshin e Flamurit, në fushë të hapur, për t'i dërguar parlamentit antihistorik e antipopullor të Shqipërisë një memorandum me disa kërkesa në mbrojtje të historisë, sepse rrënimi i saj do të ishte rrënimi i kombit dhe, në mos sot, nesër do ta çonte Shqipërinë në një luftë civile që nuk e dëshirojmë.

I dyti krim i rëndë që u bë në këto 20 vjet nën flamurin e zi të antikomunizmit është spekulimi me disa shifra të vrarësh duke i konsideruar ato krime të komunizmit.

Nuk përjashtohet mundësia që në 50 vjet punë të mos jenë bërë gabime të veçuara, por nuk mund të pranohet kurrësesi se armiqtë e popullit na paskan qenë miq të popullit dhe se, vrasësit e popullit nuk paskan qenë kriminelë, por heronj vetëm e vetëm se ishin anitkomunistë. Që ishin antikomunistë ne e dimë, por dimë se ishin edhe fashistë me Musolinin e pronazistë me Hitlerin, se disa nga këta s'kishin në zemër vatanin, por kishin Vatikanin, i cili në luftën e Dytë Botërore ishte profashist aq sa i bënte letër Ruzvelit të mos e ndihmonte Bashkimin Sovjetik, por të ndihmonte Hitlerin, sepse Hitleri, sipas Vatikanit, ishte njeri i mirë që po luftonte komunizmin, ndërsa Benito Musolinin po ky Vatikan i Papa Pius XI e shpalli të dërguar të Perëndisë. Që ishin antikomunistë ne e dimë, por dimë edhe se ishin kolaboracionistë dhe kolaboracionistët në çdo vend të botës, me sistem komunist apo kapitalist qoftë, çoheshin në plumb. Në Shqipëri pas vitit 1944 u ekzekutuan vetëm disa krerë të veçuar dhe ajo akuzohet sot për krime të komunizmit, kur De Goli në Francë çoi në plumb 12 mijë kolaboracionistë dhe Francën sot nuk e akuzon askush për krime të kapitalizmit. **Kolaboracionistët në asnjë vend të botës as falen dhe as rehabilitohen.** Shqipëria është i vetmi vend në botë që rehabiliton kolaboracionistët, prandaj përgjegjësinë historike për këtë krim do ta mbajnë qeveritë dhe parlamentet e këtyre 20 vjetëve. Le të mos harrojmë se kur japonezët sulmuan befasisht Përl Harbërin, për arsye sigurie, shteti amerikan i presidentit demokrat Ruzvelt hodhi në pranga dhe arrestoi plot 130 mijë nënshtetas amerikanë me origjinë japoneze dhe i internoi e mbajti nën survejim nëpër kampe përqëndrimi. Askush nuk e akuzon Amerikën sot për krime të kapitalizmit, edhe pse shumica e të 130 mijëve në ato kampe vdiqën. Atëherë pse u dashka akuzuar Shqipëria e vogël për krime të komunizmit se paska internuar disa pak njerëz? Pse u dashka akuzuar Shqipëria dhe jo Anglia që pas Luftës së Dytë Botërore i dënoi në masë e pa asnjë mëshirë kolaboracionistët, gjithë bashkëpunëtorët e nazizmit?

Akuzohet Shqipëria se paska eleminuar 20 a 30 banditë terroristë dhe banda terroriste që erdhën nga jashtë për të rrëzuar me dhunë pushtetin popullor në fillim të viteve pesëdhjetë, ndërsa në Greqinë fqinje xhelatët Plastiras dhe Venizellos vetëm në vitin 1952, pasi

ekzekutuan me urdhër të amerikanëve Heroin e madh të popullit grek Niko Bellojanasin, për shpëtimin e të cilit u ngrit në këmbë populli shqiptar dhe gjithë popujt e botës, njëherësh ishin të dënuar me vdekje dhe prisnin ekzekutimin plot tre **mijë patriotë grekë**. Imperialistët e Europës as thanë e as thonë qoftë edhe një fjalë për krimet e botës kapitaliste, ato që u bënë nën diktaturat e Pinoçetit në Kili e të Frankos për 40 vjet në Spanjë, 500 mijë komunistëve të vrarë në Indonezi, miliona varre në Vietnam, torturat në Guantanamo e të tjera e të tjera.

Flitet e stërflitet për një numër të burgosurish në socializëm, por nuk flitet asnjë fjalë për rreth 170 mijë shqiptarë që kanë kaluar nëpër burgjet e Shqipërisë dhe të Europës në këto 20 vjet. Vetëm në burgjet greke ndodhen sot mbi 9 mijë shqiptarë. Një shtet antishtet e kemi, por populli nuk e di sa mijëra bij të vet ndodhen sot në burgjet e Greqisë, Italisë e shteteve të tjera. Përse nuk jepen këto shifra?

Kush është burgosur e pushkatuar në 50 vjet socializëm janë të shkruara, po ju zotërinj kriminelë kapitalistë ku i kini të shkruar rreth shtatmijë shqiptarë që u vranë e u plagosën vetëm në vitin 1997, ku i kini të shkruar 8300 shqiptarë të vrarë vetëm për çështje pronash, ku i kini të shkruar 1700 shqiptarë të vrarë për gjakmarrje, ku i kini të shkruar 1500 shqiptarë të mbytur në det, të vrarë në kufijtë grekë e maqedonë, të mbytur në lumenjtë e Greqisë, të vrarë me njeri-tjetrin qyteteve të botës; ku i kini të shkruara rreth dymijë shqiptarë të vetëvarur, të vetëhelmuar, të vetëmbytur në lumenj për arsye varfërie; ku i kini të shkruara 1600 shqiptarë të humbur nëpër botë; ku i kini të shkruara 2300 fëmijë të vdekur për arsye varfërie e sëmundjesh të shërueshme; ku i kini të shkruara 17 mijë fëmijë të mbetur jetimë; ku i kini të shkruara rreth 25 mijë fëmijë që nuk shojnë në shkollë e lypin rrugëve; ku i kini të shkruara 750 krime brënda familjes çdo vit, ose 15 mijë krime në 20 vjet; ku i kini të shkruara mbi dy mijë fëmijë të vdekur për mungesë ilaçesh, të djegur nëpër baraka, apo duke mbledhur gurë kromi dhe hekurishte për bukën e gojës; ku i kini të shkruara 800 fëmijë të vegjël që rrojnë në kullat e ngujimit, të cilët nuk mund të shkojnë në shkollë e të shijojnë dritën e diellit nga që i vret gjaksi e po kështu mbi dy mijë të rritur; ku i kini të shkruara rreth 2 mijë shqiptarë që vdesin çdo vit vetëm nga ajri i helmuar i qyteteve të mëdha si Tirana, Elbasani, Durrësi etj; ku i kini të shkruara rreth 4500 të vdekur çdo vit vetëm për mungesë shërbimi mjekësor; ku i kini të shkruara 200 mijë aborte në 20 vjet (dhjetë mijë për çdo vit) pra 200 mijë fëmijë të marrë para se të lindin; ku i kini të shkruara të 365 ditët e vitit në të cilat derdhet gjak pothuajse çdo ditë dhe shifra e të vdekurve është e llahtarshme, sepse shënon mbi 50 mijë shqiptarë që humbën jetën në këto 20 vjet, midis të cilëve edhe 250 policë? Ku i kini të shkruara disa dhjetra mijë të pa strehë dhe mbi nëntë mijë të vdekur e të aksidentuar nëpër rrugët automobilistike dhe më në fund ku i kini varrosur Remzi Hoxhën dhe kush u dënua për vrasjen e tij barbare?

I treti krim i madh i kapitalizmit është shatërrimi pothuajse total i klasës punëtore dhe i bujqësisë. Mbyllja dhe shatërrimi i të gjitha uzinave dhe kombineve, i të gjitha fabrikave, centraleve, fermave, kthimi i tyre në gërmadha, kalimi në skrap që nga uzina moderne "Petro Papi" në Korçë e deri te Azotiku së fundi në Fier, shfrytëzimi barbar i naftës nga firmat e huaja, minierave të kromit e të tjera e të tjera; shkatërrimi i fushave, tërë sistemeve ujitëse e hidroforeve, vreshtave, kthimi i bujqësisë 100 vjet pas. Ku i kini parajsën që i premtuat popullit ju zotërinj kriminelë kapitalistë kur një milionë e 500 mijë shqiptarë, punëtorë e fshatarë bënë yrash nëpër botë për bukë e gojës, kur rreth një milionë ndodhen brenda vendit të papunë? A i kini shënuar në fletoren e "parajsës së popullit ju zotërinj kapitalistë kriminelë 780 mijë shqiptarë që kanë emrat në listat e dyqaneve ku kanë marrë bukë e ushqime për t'i paguar më vonë? A i kini shënuar në ditatë tuaj emërat e mbi 25 mijë

fëmijëve që lypin nëpër rrugët e qyteteve, po të atyre mijërave që nuk ndjekin shkollën dhe nuk dinë të shkruajnë as gërmën A? A i kini shënuar në ndërgjegjen tuaj rreth 48 mijë familje që kanë nevojë të ngutëshme për strehim, por është jashtë mundësive të tyre blerja e apartamenteve në kompanitë e ndërtimeve? Ju i thurët himne rinisë studentore të dhjetorit 1990, por çfarë bëtë për rininë vallë, a e dini se çdo vit 10 mijë studentë që mbarojnë shkollat e larta nuk gjejnë punë? A e dini se mbi punëtorët dhe fshatatrët ra barra më e rëndë e jetës? A e dini se në çdo katër shqiptarë njëri është me traumë mendore? Të traumatizuarit janë kryesisht punëtorë e fshatarë, njerëz të varfër, të zhytur në mjerim, që kanë humbur besimin në të nesërmen.

I katërti krim i madh në këto 20 vjet kapitalizëm është përçarja kombëtare, tronditja e thellë e atdhedashurisë, plagosja rëndë e patriotizmit, aq sa për herë të parë në historinë mijëra vjeçare që nga koha e pellazgëve shqiptari ka rënë aq poshtë sa ndryshon kombësinë. Vetëm në rrethin e Korçës gjatë regjistrimit të popullsisë ndryshuan kombësinë rreth 30 mijë veta. Ky është një krim i padëgjuar në botë dhe në këtë derexhe shqiptarin nuk e çuan komunistët, po antikomunistët antikombëtarë. Në 50 vjet luftë për liri e socializëm solidariteti dhe uniteti mes shqiptarëve arriti maja të shkëlqyera, por mjerisht kjo kala solidariteti dhe uniteti u shemb e u kthye në gërmadhë, aq sa shqiptarët sot, të ndarë e të droguar me krahinarizma e lokalizma, zihen edhe për gjuhën standarde të shqipës së lashtë, duke treguar kështu një shkallë shumë të ulët të vetëdijes kombëtare. **S'ka gjë më të trishtuar për një komb, ca më tepër për një komb me fat tragjik të ndarë në pesë shtete, i cili 40 vjet më parë mori vendimin e shenjtë historik për njësimin e gjuhës letrare kombëtare dhe pasi ndërtoi një ndërtesë të shenjtë, dalin disa terroristë për ta hedhur në ërë.** Këta njerëz, toskë apo gegë qofshin, priftërinj apo hoxhallarë, ortodoksë apo mysilmanë, republikanë apo monarkistë, demokratë apo komunistë nuk janë gjë tjetër veçse mercenarë të krimit mbi të cilët duhet të bjerë vetëm mallkimi.

S'ka murtajë përçarëse më të turpshme e më të tmerrshme se sa të vjellësh vrerë deri mbi heronjtë e lirisë, t'i urresh e t'i paraqesësh sot ata gati si gangsterë e terroristë. Në vitet e luftës ka jo një, por ka disa raste kur oficerët nazistë gjermanë, të mahnitur para një partizani të vetëm që nuk dorëzohej e luftonte i rretuar nga një kompani e tyre, apo tre partizanë të vetëm, apo një pionier partizan 14 vjeçar si Met Hasa që lufton i vetëm mes gjermanëve e i hidhet mitralierit nazist në grykë, mblidhnin forcat e tyre vrasëse dhe i nderonin këta heronj shqiptarë sipas të gjitha rregullave ushtarake me shkrehje armësh. Sigurisht nazistët gjermanë e bënë këtë veprim për të ndikuar tek ushtarët e tyre, që kështu duhet të luftonin. Sidoqoftë ky ishte një nderim. Një nderim i imponuar nga heroizmi i titanëve tanë partizanë. Qeveritë shqiptare të këtyre 20 vjetëve nuk i nderojnë heronjtë tanë të lirisë as sa nazistët gjermanë. Ku po shkojmë? Ku po shkojmë? Gjaku i heronjve të lirisë akuzon! Ai sot akuzon kriminelët, akuzon dy partitë e mëdha, atë Demokratike e atë Socialiste, pse nesër mund të na akuzojë edhe ne komunistëve nëqoftëse nuk do ta ashpërsojmë luftën tonë demokratike kundër krimit. Monumenti i Pesë Herojve të Vigut ndodhet ende mes plehrave. Qindra vlonjatë kërkojnë që monumenti i tyre të çohet në Vlorë. Partia Socialiste me allçaket e saj të majta, që e ka forcën njerëzore për ta marrë mbi supë këtë monument, hesht. Ndërkaq Kiri, Drini e Buna këndojnë turpin.

Shqiptari sot është bërë skllav i së keqes, i cili pa pikë të turpit dhe të marres hedh baltë mbi lirinë dhe brohoret tiraninë. Diçka më shumë se 120 vjet më parë plasi në Amerikë lufta civile mes veriut dhe jugut. Dhe përsë vallë? Sepse Abraham Linkoln shpalli lirinë e skllavëve. Por kjo s'i pëlqeu Jugut dhe u nda nga Veriu si shtet më vete e me president tjetër. Pas pesë

vjet luftë Jugu humbi dhe Amerika u ribashkua. Linkolnin e vranë me atentat në një teatër, por sistemi i skllavërisë, falë tij, nuk funksionoi më. Xhelati i skllëvërve, ish presidenti Xheferson Devis, jetoi jetën e tij private dhe vdiq pas 25 vjetësh. Këtë xhelat të madh, që i kushtoi popullit amerikan lumenj gjaku të pafajshëm vetëm e vetëm për të mbrojtur sistemin e skllavërisë së zezakëve shkuan dhe e qanë me lot dy mijë ish skllëvër zezakë. Kjo çudi i madhe ka ndodhur 122 vjet më parë. E kjo gjithësesi s'kish arësye të tregohej në një raport kongresi po të mos jetonim ditët kur turma të tromaksura shqiptarësh janë gati të shkojnë në vetmohim për ata që e kanë përçarë popullin, që i kanë grabitur të gjitha pasuritë kombëtare, që rrojnë si mbretër ndër vila superluksoze në Tiranë e brigjeve të detit. Duket së këtyre turmave me shpirt skllavi tirania kapitaliste u ka çmontuar trurin dhe i ka kthyer në disa robotë të gjallë që s'dinë ku shkojnë e s'dinë çfarë bëjnë. Ç'mund të thuash kur qytetari i ngujuar me tërë familjen, që s'ka bukë për të ushqyer kalamajtë e vegjël, të cilët s'dalin dot as të lozin jashtë si fëmijët e tjerë e jo të venë në shkollë, megjithatë më skllavë se skllavi thërret: Rroftë Sali Berisha! Del Edi Rama para ish-partisë së veteranëve të luftës, zbras tonelata tritol kundër komunizmit dhe Enver Hoxhës, ndërkaq turma o e mban turpin për këna mbi thinja, o thërret: Rroftë Edi Rama! Ne duhet ta përbuzim këtë rit turpi. Ne duhet ta shohim ralitetin në sy, një realitet shumë i hidhur, ku nuk gjallon shpirti i protestës siç po gjallon sot pothuaj në të gjitha shtetet e botës. Mjaft më me mburrje folkorike se jemi kështu e ashtu. T'ia themi popullit në sy se një shoqëri që nuk proteston kundër së keqes mbjell gjumin dhe korr skllavërinë.

I pesti krim i madh në këto 20 vjet kapitalizëm është shkatërrimi i shëndetësië dhe arsimit, që në socializëm u ngritën nga e para dhe ishin falas për çdo shqiptar, një e vërtetë kjo që as antikomunistët më të egër s'kanë mundur të mohojnë. Shërbimi mjekësor në fshatra pothuajse nuk ekziston fare. **Spitalet nëpër qytete ngjajnë më së shumti me stalla bagëtish dhe të sëmurët duhet të blejnë ilaçet vetë dhe paguajnë mjekun me shuma të mëdha parash, aq sa disave që s'kanë mundësi të përballonjë shpenzimet janë më të lumtur të vdesin se sa të rrojnë në një tmerr pa fund.** Në afro 50 vjet socializëm as që njihej fjala SIDË, jo më të vuhej prej saj. Zyrtarisht jepen vetëm 478 vetë me SIDË në vit, por shifra është shumë më e madhe, pse mjaft shqiptarë e mbajnë të fshehur këtë sëmundje që u dhuroi kapitalizmi. Dikur Stalini tregonte për disa njerëz që nuk i shqetësonte humbja e disa shokëve, por humbja e një pele. Kur Stalini i pyeti se si ishte e mundur kjo gjë, ata iu përgjigjën: "Njerëz bëjmë prapë, pelë s'bëjmë dot, pa provo të bësh një pelë". Sot në Shqipëri humbja e një njeriu konsiderohet më pa vlerë se humbja e një qeni. Kjo është fytyra e kapitalizmit. E njëta tragjedi ka ndodhur me arsimin, mijëra fëmijë nuk shkojnë fare në shkollë dhe rriten analfabetë. Mijëra të tjerë dalin "analfabetë" me diploma universitetesh private. Ju kujtojmë kriminelëve kapitalistë se nuk ishte faji i komunistëve që vendet e tjera të Europës kishin 800 vjet më parë universitete e më 1945 nëntëdhjetë për qind e shqiptarëve ishin analfabetë. Ishin komunistët ata që brenda 10 vjetësh e zhdukën analfabetizmin dhe nga dyert e shkollave, të universiteteve dhe akademive doli një plejadë e artë shkencore në të gjitha fushat. Po ju zotërinj kapitalistë si nuk nxorët të tillë gjigandë në këta 20 vjetët tuaj? Sepse diploma sot blihet me parà dhe kësisoj injoranca ngre kala. Buldozeri kriminal i kapitalizmit vërshoi të shkatërroi dhjetra institucione shkencore të shtrira në Tiranë e tërë vendin dhe Akademinë e Shkencave. Ndërkaq doktor-profesrët shtohen pa fund, të cilët qëndrojnë para plejadës së artë të njerëzve të shkencës përgatitur në socializëm siç mund të qëndrojnë kërmijtë para luanëve.

I gjashti krim i madh në këto 20 vjet kapitalizëm është shkatërrimi i familjes. Brenda 20 vjetësh janë numëruar rreth 50 mijë divorce. Shkon çifti të ndahet në gjendjen civile pas 35

vjetësh martesë me pretendimin “nuk na puqet karakteri”. Pas 35 vjetësh e kuptuan këta pleq imoralë e viktima telenovelash se qenkishin të kundërt në karakter? **Krimi në familje në këto 20 vjet ka bërë kërdinë. Baballarë që vrasin djalin e tyre, vëllezër që vrasin vëllezërit, nëna që braktisin a shesin fëmijët. 700 krime të rënda në vit brenda familjes në një popull të vogël si ky i yni përbëjnë një shifër tmerronjëse.** Dhe në këtë shifër nuk bëjnë pjesë mijëra rrahje të gruas nga burri dhe ndonjëherë edhe anasjelltas, pra kur gruaja rreh burrin e në disa raste edhe e vret. **Mjafton të lexosh e të shohësh këto kronika të zeza, të përditshme, që të bindesh se në fytyrën e kapitalizmit rrjedhin si ujëra të zeza të gjitha pislleqet e kësaj bote, se s’ka gjë më të shëmtuar e më të ndyrë se fytyra e kapitalizmit, sidomos e të ashtuauajturit kapitalizëm shqiptar, i cili po e çnjerëzon në mënyrën më të poshtër e më të mallkuar jetën e këtij vendi, aq sa nesër, ndoshta, ujku do të konsiderohet më fisnik se njeriu.**

I shtati krim i madh në këto 20 vjet kapitalizëm është poshtërimi kombëtar. Kurrë ndonjëherë në histori Shqipëria nuk është poshtëruar nga të huajt se sa në këto 20 vjet. Atdheu ynë me ushtrinë më të fortë në Ballkan e më gjerë deri në vitin 1990 u poshtërua nga një bandë e vogël greke më 1994 që hyri në repartin e Peshkëpisë, poshtëroi rreth 200 ushtarë të lënë pa armë, vrau oficerë dhe iku pa i hyrë gjemb në këmbë. Nuk mund t’i quash ndryshe veçse poshtërim minat serbe brenda kufirit shtetëror, ku u sakatuan dhjetra fshatarë, ndërkaq mbi shtetin e vdekur shqiptar bënë dasëm krimbat. As huliganët maqedonas nuk qëndruan larg serbëve me vrasjet e shqiptarëve në kufi dhe britmat “Shqiptari i mirë është vetëm i vdekur”. Në enciklopedinë e Maqedonisë e në libra të tjerë shqiptarët janë fyer rëndë. Po shovinistët grekë kanë qenë për 20 vjet me radhë më arrogantët. Provokacionet e shëmtuara në Himarë e në tërë zonën e Jugut kanë qenë të pandërprera e tepër fyese për popullin tonë. Tepër fyese gjithashtu britmat e ushtarëve grekë nëpër parada “Me lëkurën e shqiptarëve do të bëjmë këpucë”.

Populli shqiptar dhe veçanërisht Enver Hoxha që prej 70 vjetësh është përpjekur të rrojë në miqësi më popullin heroik grek. Komunistët shqiptarë u vunë në mbështetje të popullit grek në luftën italo-greke. Komunistët shqiptarë hapën portat për ushtrinë demokratike greke gjatë luftës civile, u ngritën spitale për grekët brenda tokës tonë, më në fund, pa përfillur kërcënimet, u lejuan komunistët grekë të kalojnë nëpër Shqipëri e mandej në demokracitë popullore. Por shteti grek, as dje dhe as sot nuk e ka dashur këtë miqësi që shqiptarët kanë dashur në shekuj, përkundrazi ruan edhe sot e kësaj dite ligjin absurd të luftës me Shqipërinë, megjithesë Greqia është anëtare e NATO-s.

Më 21 dhjetor 1951 u ekzekutua në Athinë një komunist shqiptar i quajtur Koço Kazanxhiu. Para togës së ekzekutimit ai thirri: “Rroftë Shqipëria! Rroftë Greqia! Rroftë Partia Komuniste Greke!” Përse u torturua barbarisht në qelitë e errëta të kriminelit Venizellos ky njeri? Sepse kishte shërbyer si i deleguar i Enver Hoxhës pranë gjeneralit Markos për të ndihmuar Partinë Komuniste Greke gjatë luftës civile. Ai u kap me një pjesë të Shtabit të Markosit në Malin e Gramozit. U torturua me zemërimin e Zeusit që të bindej për të dëshmuar në OKB se Enver Hoxha i kishte dërguar për të ndërhyrë në punët e brendshme të Greqisë dhe se kish provokuar Greqinë. Por gjatë vitin 1951 e më parë, jo Shqipëria kish provokuar Greqinë, po Greqia kish kryer mbi 100 provokacione ndaj Shqipërisë, shifër që e ka pohuar edhe militanti komunist grek Ilija Karas në kongresin e dytë të Partisë të komunistëve shqiptarë. Po atë vit më 18 Shtator 1951, Venizellosi pati deklaruar në Janinë se herën tjetër do të vizitonte Epirin e Veriut të çliruar, domethënë Shqipërinë e Jugut. Mbetën vetëm një ëndërr prej monarko fashisti këto fjalë.

Por me përmbysjen e socializmit qarqe shoviniste greke kanë provokuar disa herë Shqipërinë dhe integritetin e saj tokësor. Natyrisht shteti grek me disa deputetë e ministra gangsterë ka gjetur shesh e ka bërë përshesh në Shqipëri, sepse shteti shqiptar është një kufomë e gjallë e gjunjëzuar para presioneve të shtetit grek. Kohët e fundit një funksionar i organizatës fashiste "Omania" i shkruan Ministrit të Jashtëm grek për të nisur luftën për çlirimin e Vorio-Epirit. Thirrje për luftë ka bërë disa herë hapur edhe konsulli grek në Korçë, i quajtur i Ikonos, i cili edhe në veshje e në surrat të krijon më shumë përshtypjen e një mafiozi që merret me treginë e drogës se sa të një diplomati.

Në kufirin greko-shqiptar të krijohet përshtypja se po fryn erë gjaku. Jo se në Greqi sipas të dhënash zyrtare janë vrarë 157 shqiptarë shumica nga ekstremistët grekë u ujçer të Vorio-Epirit. Po se shovinizmin ky shtet e ka në gjak. Kjo duhet kuptuar mirë si nga komunistët shqiptarë, si nga komunistët grekë, të cilëve u takon të bëjnë ç'është e mundur për të parandaluar retë e një tragjedie që duket në horizont. Partia Komuniste Greke, që po hyn në nëntëdhjetëvjetorin e saj, ka një histori të lavdishme, është sot partia më e fuqishme në Europë. Ajo ka qenë korekte me Partinë tonë. Marrëdhëniet e dy partive tona kanë qenë të sinqerta. Ne besojmë se ajo, duke qenë edhe forca e tretë politike në vend, do të japë kontributin e saj të padiskutueshëm në të mirë të dy popujve tanë. Duhet parandaluar të papriturat, sidomos një konflikt i mundshëm, një luftë e padëshirueshme. Nesër vetë imperializmin mund ta shtyjnë interesat e tij për ta ndezur këtë luftë e për ta menaxhuar atë që gjaku i dy popujve tanë të kthehet në monedha dollarësh e eurosh në xhepin e vet. Për 20 vjet shovinistët grekë s'kanë rreshtur për të helenizuar Shqipërinë e Jugut në vijën Llogara-Këlcyrë-Korçë nëpërmjet ekspansionit të gjuhës greke, ndërtimit të varrezave greke e me eshtra fshatarësh shqiptarë, ngritjes së kishave të reja me arkitekturë greke, shkollave greke ku s'ka grekë, ndryshimit të emrave të shqiptarëve, presionit ndaj shqiptarëve të deklarohen vorioepirotë duke u siguruar pensione joshëse me euro, presionit tjetër për t'u vetëdeklaruar në kundërshtim me të vërtetën kombësinë dhe fenë gjatë regjistrimit të popullsisë e të tjera. Kjo politikë e çmendur shoviniste greke dhe ky gjunjëzim i shëmtuar i shtetit shqiptar para saj mund t'i çojnë dy popujt tanë drejt greminës. Politika shoviniste greke është në dëm të vetë popullit të lavdishëm grek dhe minoritetit të tyre në Shqipëri, ashtu siç do të ishte në dëm të popullit çdo aventurizëm i sëmurë, çdo frymë urrejtje ndaj popullit grek. Minoriteti grek në Shqipëri përbëhet nga njerëz të mrekullueshëm dhe ka jetuar në të mirë e në të keq në harmoni me shqiptarët. Ka një lidhje të vjetër deri në përzierje mes dy popujve tanë, të cilët dëshirojnë të rrojnë në paqe e miqësi. Rroftë Paqa! Rroftë miqësia mes popujve!

Shokë e shoqe,

Mund të numëronim edhe shtatëdhjetë e shtatëqind krime të kapitalizmit gjatë këtyre 20 vjetëve të mjergullta në Shqipëri, por edhe kaq boll janë për të kuptuar se kapitalizmi nënë e babë ka krimin dhe vetëm krimin. Dikur Herman Geringu deklaronte: **Unë s'kam ndërgjegje. Ndërgjegja ime është Hitleri.** Ndërgjegja e politikanëve shqiptarë të këtyre 20 vjetëve është vetëm posti dhe paraja, ndërgjegja e tyre është krimi. Po të kthehesh në shkallë krimin të 20 vjetëve të fundit maja e shkallëve do të prekte planetin Mars. Sepse ndër këto krime të 20 vjetëve do të zinte vendin e tij dhe krimi i shkatërrimit të ushtrisë e mbrojtjes, i cili është ndër më të llahtarshmit. Flitet se nga shitja e armëve dhe municioneve, kthimit në skrap dhe njëmijë e njëqind tankave, anijeve luftarake, aeroplanëve, mijëra e mijëra gryka zjarri topash e mortajash, një kontigjenti raketash e rezerva mjetesh të tjera ushtarake janë përfituar mbi shtatë miliardë dollarë. Në fakt pasuria ushtarake ka qenë shumë më e madhe, por shifra e përfitimit nga qeveritë mafiozë të këtyre 20 vjetëve nuk do të bëhen transparente kurrë e

populli nuk do t'i mësojë kurrë. Populli kurrë s'do të mësojë as shifrën e saktë të njerëzve të emigruar nëpër botë. Popullit nuk i thuhet se edhe sot e kësaj dite Shqipëria ka shifrën më të lartë të emigracionit në botë. Populli ynë është i dënuar të ushqehet me gënjestra e asnjëherë të mësojë të vërteta. Kjo është Shqipëria e ditëve tona.

S'ka më as ajër të pastër se është i helmuar nga tymrat e plehurat; s'ka më mrekulli pyjesh, se i ka prerë sopata e krimit; s'ka më as shtrate lumenjsh, se i kanë ngrënë makineritë e krimit dhe dejt ka shtrirë dhëmbët e gjatë si peshkaqen e po ha tokën, s'ka më kurrëfarë sigurie për jetën, se koha e sotme i djeg edhe njerëzit e drejtësisë nëpër makina siç digjte Hitleri njerëzit e kampeve të përqëndrimit nëpër krematoriume, se edhe vetë ligjet e drejtësisë janë më të zeza se pelerinat e gjyqtarëve, sepse sistemi i drejtësisë është totalisht i kriminalizuar, kështu që ajo nuk dënon krimin, por buron krimin. 26 fukarenj, burra e gra, fëmijë të vegjël humbën jetën para dy vjetësh në tragjedinë e Gërdecit. Të 26 fletë në varre, ndërsa vrasësit dolën nga burgu e fletë ende në shtretër të ngrohtë në shtëpitë e tyre, nuk paraqiten as në seancat tragjekomike gjyqësore dhe bëjnë estradë me rregullat e një drejtësie të padrejtë. Vrasjet e 21 Janarit 2011 në demonstratën para kryeministritë pothuajse u harruan, gjë që tashmë nënkupton se në çdo demonstratë do të ketë të vuarë, "prandaj ti popull prano urtësinë e skllavit". Kjo është Shqipëria që nuk duhet të jetë. Nuk jemi ne komunistët që duhet të japim llogari për krime të pa qena, por jini ju kapitalistët që duhet të japin llogari, sepse në 20 vjet keni bërë 20 milionë krime që ne sigurisht se do t'i shruajmë në librin e zi të kapitalizmit. Ne ju akuzojmë! Ne do të rezistojmë! Ne do t'ju luftojmë! Ne do t'ju dërrmojmë! Ne do të fitojmë! Poshtë kapitalizmi! Rroftë socializmi!

Shokë e shoqe,

Socializmi nuk është krimi, por antikrimi. Socializmi nuk është tirania e pakicës, por vullneti legjitim i shumicës. Natyrisht përmbysja e socializmit as si sistem botëror dhe as në Shqipëri s'mund të kalohet shkarazi. Nuk do të ishim komunistë marksistë-leninistë nëqoftëse tragjedinë e komunistëve në fundin e viteve tetëdhjetë do ta justifikonim me një fjalë e dy fjalë të vetme: "Na tradhëtoi Hrushovi, na tradhëtoi Gorbaçovi, na tradhëtoi Ramiz Alia" dhe kaq. Nuk është vetëm kaq. Çështja kërkon analizë shumë më të thellë. Hrushovi tradhëtoi sepse gjeti terren për ta ushtruar tradhëtinë, ndryshe shpata e diktaturës së proletariatit do t'i priste kokën siç pret drapëri një lakër. Ne e kemi denoncuar tradhëtinë e Ramizi Alisë, të Byrosë Politike e të Komitetit Qëndror pas vdekjes së Enver Hoxhës, por kapitulli s'mund të mbyllet më kaq. Si u bë e mundur që udhëheqja e Partisë të ngrinte flamurin e bardhë para kundërrevolucionit? Si e përse u akumulua pakënaqësia e një mase të konsiderueshme shqiptarësh që çoi në kundërrevolucion? Duhet kërkuar rrënjët e sëmundjes. Dhe ato rrënjë mund të gjenden vetëm duke iu referuar shkencës marksiste-leniniste. **Marksizëm-leninizmi është mjeku më i madh që zbulon ku është e si nisi sëmundja, ku na pikon çatia.**

Ne, komunistët shqiptarë pa mohuar aspak padrejtësi të veçuara që mund të jenë bërë, dhe padyshim që janë bërë, hedhim poshtë me neveri shpifjet për krime të komunizmit dhe jemi të ndërgjegjshëm se këto shpifje fabrikohen vetëm për të mbuluar krimet e kapitalizmit. Maskarada e fabrikimit të "krimeve" të komunizmit, në të vërtetë nuk lindi para 20 vjetësh, por qysh një shekull më parë, sapo në Rusi triumfoi Revolucioni i Tetorit e kundër pushtetit sovjetik u hodh me tërbim borgjezia dhe imperializmi botëror. **Pakti antikomunist i partive të borgjezisë së re shqiptare, si dhe i gjithë shteteve borgjeze të Europës nëpërmjet Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës nuk është gjë tjetër vetëm se pakti antikomunist i Gjermanisë naziste dhe i Japonisë militariste më 1936, më të cilin u bashkua dhe Italia fashiste. Këto tri fuqi të errësisës, për të ndarë botën mes tyre,**

dolën me flamurin e antikomunizmit, ashtu si sot borgjezia e të gjitha shteteve, për të ruajtur sistemin e tyre kapitalist, fabrikojnë “krime” të komunizmit, që të ngjallin veçanërisht tek brezi i ri frymën e urrejtjes ndaj komunizmit.

Në planin planetar, pas Luftës së Dytë Botërore, u ndodhën ballëpërballë dy sisteme: sistemi i vjetër kapitalist dhe sistemi i ri socialist. Idelogjë e teoricienë të ndryshëm kanë folur gjatë gati 50 vjetëve për “Luftën e ftohtë”, por edhe “krime të komunizmit” në Bashkimin Sovjetik, Kinë e gjetkë. Që ka pasur Luftë të Ftohtë, sidomos mes Amerikës e Bashkimit Sovjetik, kjo është e vërtetë. Por në botë gjatë 50 vjetëve ka ekzistuar edhe një luftë e nxehtë, për të cilën ideologët, teoricienët dhe historianët e kapitalizmit nuk thonë asnjë fjalë, ose nuk demaskojnë shkaktarët e luftërave dhe të gjakderdhjeve. Lufta e Dytë Botërore i kushtoi njerëzimit 60 milionë njerëz. Kjo shifër është pranuar. **Por as imperialistët, as komitetet e paqes në botë s’kanë thënë e nuk thonë as sot e kësaj dite se si rezultat i luftërave lokale, si rezultat i ndërhyrjeve brutale imperialiste anembanë globit, si rezultat i luftës në Vietnam, në Amerikën Latine, në Afrikë, apo edhe në Europë, si rezultat i bllokadave, njerëzmi ka humbur mbi 70 milionë njerëz.** Asnjë fjalë nuk thuhet për këtë shifër. Për të fshehur fytyrën e këtij krimi, imperializmi dhe e tërë borgjezia ndërkombëtare kanë gërmuar të gjejnë ndonjë krim në kohën e Stalinit, të Leninit e në kohën e Mao Ce Dunit. Tani së voni gërmojnë të gjejnë edhe në Shqipëri në kohën e Partisë së Punës.

Shokë e shoqe,

Ne komunistët shqiptarë e kemi deklaruar dhe deklarojmë se epoka e Partisë së Punës ka qenë epokë transformimesh progresive dhe nuk ka qenë epokë krimesh. E kemi deklaruar dhe e deklarojmë se nuk i bëjmë gjyqin Partisë së Punës dhe i qëndrojmë deri në fund kësaj fjale. Ndërkaq ne nuk mohojmë se në atë rrugë të gjatë, në luftë me prapambetjen shumëshekullore, në luftë me mentalitete të vjetra feudale e regresive, në luftë me ideologjinë borgjeze dhe reaksionare çdo gjë ka rrjedhur si lumë floriri, se s’ka patur dobësi e të meta, se s’ka patur edhe gabime. Edhe gabime ka patur, ato duhen pranuar, ndryshe s’të beson njeri. Lenini në kohën e vet pati hedhur idenë se një parti që nuk sheh e nuk pranon gabimet e saj para popullit nuk mund të jetë parti serioze. Duhet pranuar se në vitet e fundit të jetës së vet në socializëm Partia e Punës nuk pati guximin e duhur t’i shihte me syrin e duhur kritik disa të meta e dobësi, disa gabime të bëra, që të ishte transparente me popullin e t’i pranonte ato me frymë leniniste e të bënte kthesën e duhur për t’i riparuar, madje të kërkonte mendimin e popullit për të shpëtuar revolucionin.

Në këtë raport e shtrojmë në mënyrë marksiste e leniniste problemin që analiza e shkaqeve që çuan në përmbysjen e socializmit **duhet bërë.** Ndërkaq, nëse në këtë raport ndalemi fare shkurt në ndonjë të metë e dobësi, kjo s’do të thotë se analiza u bë. Do të ishte naiv një pretendim i tillë. Sigurisht sot mund të themi diçka me dëshirën e mirë që t’i shërbejë ndoshta sadopak një analize të ardhme. Natyrisht një analize të urtë, një analize realiste, shkencore, në një frymë marksiste-leniniste. **Jo të flakim edhe fëmijën tok me ujin e pistë. Sepse kështu nuk do të bënim analizë, por do të bënim antianalizë, do të bënim krim.**

Sa ishte gjallë Enver Hoxha, ai jo njëherë në fakt bëri thirrje për vigjilencë kundër rrezikut të djathtë. Tërë veprën e tij të shkruar e përshkon si një fill i kuq kjo ide. Sot, duke e vështruar me urtësi të kaluarën, duke reflektuar po me urtësi marksiste për çka ndodhi, mund të dilet në konkluzion se:

Së pari, vigjilenca ndaj rrezikut të djathtë nuk ka qenë kurdoherë në lartësinë e duhur. Çështjen e rrezikut të djathtë Stalini e pati trajtuar në Internacionalen Komuniste qysh më 27 mars 1925, pra plot 86 vjet më parë, të cilit i është referuar edhe Enver Hoxha në Kongresin e Dytë të komunistëve shqiptarë më 1952. **Kalimi nga një periudhë ngritjeje në një periudhë qetësie, theksonte Stalini, i shton mundësitë e rrezikut të së djathtës.** Duke e trajtuar thjesht e qartë këtë çështje Stalini i referohej edhe Leninit në broshurën **“Sëmundja foshnjore e majtizmit”** dhe shtonte se po të ishte gjallë Lenini tani do të shkruante një broshurë **“Mbi sëmundjen pleqërore të rrezikut të djathtë”**.

Çfarë provoi koha në Partinë Bolshevike? Ajo kishte patur një periudhë ngritjeje në luftë e madhe patriotike dhe në vitet për rindërtimin vendit të shkatërruar nga lufta, ku popujt sovjetikë humbën në fushat e betejave 27 milionë njerëz. Por me vdekjen e Stalinit, si pasojë e djathtistëve të fshehtë në kreun e Partisë, Partia dhe vendi u ndodhën në një periudhë qetësie dhe Nikita Hrushovi, aventurier i pashoq, nxiti rrezikun e djathtë, dhe në fakt, si pa kuptuar, Partia Bolshevike bëri djathtas, gjë që binte në sy në fjalime euforike e deri në deklarata si ajo e Moskës, sipas së cilës krijohet përshtypja se komunizmi ishte fare pranë. revizionizmit, e helmoi brinjë më brinjë Partinë Komuniste me të fuqishme të botës, gjë që padyshim do të ish me pasoja të rënda për mbarë lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Rreziku i djathtë u shpалos hapur edhe në Konferencën e Partisë së Tiranës më 1956, po Enver Hoxha ia preu kokën këtij rreziku dhe luftoi orë pas ore e vit pas viti ta mbante Partinë **në ngritje, në ngritje dhe vetëm në ngritje** e duke bërë vazhdimisht thirrje për vigjilencë. Me kalimin e kohës, sidomos pas vdekjes së Enver Hoxhës, rreziku i djathtë u bë tepër evident dhe jo pak, por disa mijëra komunistë, ose kaluan pa e kuptuar as vetë në pozita socialdemokrate, ose kishin hyrë si të tillë kontrabandë në gjirin e Partisë së Punës për të siguruar privilegje. **Nuk duhet harruar se ne s’patëm klasë punëtore të zhvilluar dhe në kohën e luftës jo pak komunistë vinin nga shtresat e djathta, të shkolluara, ose nga fshatarësia, e cila, sado patriote, nuk e ka shpirtin e klasës punëtore.** Gjithashtu disa të drejta borgjeze pa borgjezinë në socializëm e patën ndikimin e tyre. Jo pak komunistë me funksione të larta në parti e në shtet nisën të shohin vetëm interesat e tyre personale dhe aspak ato të popullit. Mjerisht kundërrevolucionari bëri fole në atë që mendohej se ishte koka e revolucionit. Nuk është e rastit që Partia Demokratike krijohet në vilat e ish anëtarëve të Komitetit Qëndror e të ministrave. Kështu u përgatit terreni që më 12 qershor 1992 në Kongresin e saj të dhjetë, rreth tremijë delegatë komunistë, pothuajse unanimisht, vendosën për një kalim djathtas, pra shndërrimin e një partie komuniste në një parti kapitaliste. Rreziku i djathtë triumfoi.

Së dyti, pas restaurimit kapitalist vetë disa nga udhëheqësit më kryesorë të Partisë së Punës kanë pranuar se janë bërë gabime në luftë e klasave, gjë që krijon jo pak çoroditje. **Ne si Parti Komuniste nuk i mohojmë aspak disa dobësi në këtë aspekt tepër delikat, por konfirmojmë se vija e Partisë për luftën e klasave nuk ka qenë e gabuar. Vija ka qenë e drejtë, por në praktikë edhe gabime janë bërë.** Këto gabime nuk kanë të bëjnë vetëm me sektarizmin, i cili ka qenë disi i teperuar **kryesisht në fshat**, por edhe me liberalizmin, **kryesisht në qytet.** Jo pak të deklasuar e pinjollë të deklasuarish, socializmi dhe Partia i panë me zemër të ngrohtë, u dhanë shkolla të larta në degë speciale, u bënë inxhiniera, mjekë e artistë, punuan në institucionet më të larta shkencore, madje edhe si drejtorë të tyre, u bënë deri Artistat të Popullit, por kur u përmbys sistemi askush prej tyre nuk e vlerësoi qëndrimin e ngrohtë ndaj tyre dhe u shfaqën si përbindështa të shqyenin të vërtetën. Sot intelektualit filistin, mendjengushtë, zemërngushtë e **shpirtarës** edhe një

transferim nga kryeqyteti e quan luftë klasash! Sot edhe inisiativa e shkrimtarëve për të shkuar disa muaj a vite në bazë për të njohur jetën e gjallë të popullit, shkrimtari pseudonjerëzor e burracak e quan krejt ndryshe. Vajtjen e tij një vit apo dy në Krujë, Berat, Rubik apo Shkodër, ai nuk e quan freskim të trurit e të shpirtit, asurim të njohjes, por e quan internim! Ne, komunistët, pranojmë se ka patur keqinterpretime të vijës së Partisë për luftën e klasave, se ka patur edhe abuzime sidomos nga individë të veçuar të Ministrisë së Punëve të Brendëshme, të cilët në disa raste kanë abuzuar me detyrën dhe kanë vepruar në kundërshtim me vijën e Partisë, por nuk mund të pranojmë pallavrat e armiqve të betuar të klasës që duan të justifikojnë krimet e tyre dhe drejtësinë kundër krimit ta quajnë padrejtësi, madje genocid! Nuk mund të pranojmë deklarata mizore intelektualësh e historianësh se ata që zbritën me parashuta në vitet e para të çlirimit për të përmbysur pushtetin popullor ishin heronj. Në emër të cilës klasë bëhen këto deklarata të poshtra? Sigurisht në emër të klasës së kriminelëve. Heronj ishin pikërisht oficerët e Sigurimit të Shtetit, “Herojtë e Heshtur”, siç janë quajtur punonjësit e Ministrisë së Brendshme, që derdhën gjakun e tyre për t’i bllokuar e asgjësuar këto banda kriminale. Vetë këto 20 vjet kapitalizëm, kur lufta e klasave është e përbindëshme, na kanë bindur edhe më tepër se sa e domosdoshme është ajo në socializëm, në sistemin e diktaturës së proletarietit. Luftë klasash ka patur, por në socializëm, megjithatë, asnjë i deklasuar i vetëm nuk lihej pa punë, ndërsa sot, në kapitalizëm, të djathtët mund të hedhin me një të rënë të lapsit dhjetra mijëra njerëz me ide të majta në rrugë. Diktaturë të proletarietit ka patur, por kjo nuk nënkupton se udhëheqësit e shtetit të diktaturës qenkeshin diktatorë. **Imperialistët dhe të gjitha kastat mizore të borgjezisë tek çdo udhëheqës komunist shohin një diktator, ndërsa tek çdo udhëheqës kapitalist, i cili bën krime, madje shpall edhe luftra, shohin një engjëll.**

Së treti, kur flitet për të meta e gabime, duhen parë të dyja anët e medaljes. Njerëzit, qofshin këta edhe komunistë, qofshin këto edhe institucione, nuk janë të imunizuar nga e keqja, kështu që luftë konceptesh ka edhe në gjirin e Partisë. Edhe një pemë nuk rritet e shëndetëshme pa ia krasitur degët e thata. Krasitjet kanë qenë të domosdoshme edhe në Parti, veçse në periudha të caktuara gjithashtu mund të këtë patur dhe në fakt ka patur edhe teprime të panevojshme, sektarizëm të dëmshëm, sidomos me një numër kuadrosh që, pavarësisht nga gabimet, kishin patur kontribute të shquara në të kaluarën. Me disa nga këta ndoshta mund të merreshin masa më me kujdes, që të mos i jepej asnjë armë armikut të klasës ta përdorte kundër nesh, siç po ndodh në të vërtetë sot me kundërshtarët tanë që spekullojnë tej mase me disa ndëshkime të detyruara për momentin, por që mundet të mos ishin edhe aq ekstreme, sidomos me fëmijët dhe deri me farefisën e atyre që kishin gabuar ose ishin shpallur armiq. Ky sektarizëm është i pajustificueshëm. Sektarizmi është po aq i rrezikshëm sa djathtëzmi, në mos më keq, sepse siç thoshte Enver Hoxha, sektarizmi të armiqëson me popullin, siç edhe na armiqësoi në disa raste. Padyshim lufta e klasës brenda klasës, brenda llojit, brenda gjirit të Partisë, që u ashpërsua veçanërisht në vitet e fundit të epokës socialiste, e dëmtoi më shumë se sa e forcoi revolucionin popullor. Duke reflektuar me urtësi sot për atë kohë mund të gjykohet se pati teprime jo të vogla në fushën e luftës brenda llojit. Disa masa ndëshkimore për komunistë e kuadro të ndryshëm komunistë, elementë të shtresave të përmbysura që ishin jashtë Partisë, por që ishin shkolluar në socializëm e ndodheshin edhe në poste të nderuara, duhet t’i kenë parë me kënaqësi, si një dramë, që në fund të fundit u shërbente atyre. Kjo kënaqësi nuk u duhej dhënë këtyre njerëzve në shpirtin e të cilëve këndonte korbi i kundërrevolucionit. Jo, kurrsesi nuk u duhej dhënë.

Së katërti, kur flitet për të meta e gabime nuk duhet harruar se presioni imperialist e revisionist ndaj vendin tonë të vogël ka qenë shumë i madh dhe masat shtrënguese kanë qenë të detyruara. Trysnitë armiqësore, veçanërisht për të shmangur Enver Hoxhën nga udhëheqja, kanë qenë brenda dhe jashtë, të pashembullta e të pandërprera. Anglo-amerikanët kërkonin rrëzimin e Enver Hoxhës sepse ishte komunist, jugosllavët sepse e konsideronin nacionalist, sovjetikët sepse ishte antirevisionist e i shkëputur nga kampi socialist në fund të viteve gjashtëdhjetë. Natyrisht s'duhet harruar edhe e keqja brenda nesh. Padyshim që ka patur sabotime e veprime të gabuara, që në thelb ishin armiqësore. Në vitet shtatëdhjetë Enver Hoxha mbajti në Mat një fjalim shumë të rëndësishëm si duhej kuptuar e zbatuar demokracia në socializëm. Ky fjalim përgjithësisht u sabotua dhe demokracia si brenda në parti e si jashtë saj e mori një goditje, e cila për fat të keq erdhi duke u zmadhuar. Kur Enver Hoxha pati një goditje në zemër mund të mendohet se disa klane brenda Partisë patën një lëvizje për pushtet dhe mund të mos jetë fare pa bazë mendimi që sabotimet, deri arrestime njerëzish pa të drejtë, kanë patur edhe qëllime të largëta. **Nga ana tjetër në këto vite, duke shfrytëzuar sëmundjen e Enver Hoxhës, gjoja për të mos e shqetësuar, ka ekzistuar një farë rrethimi e bllokadë ndaj tij. Tashmë është provuar se nuk i thuhej e tërë e vërteta dhe kjo, padyshim, ka ndikuar për keq. Nga ana tjetër, në kthesa të forta revolucionare, “revolucionarë” antirevolucionarë, kur është fjala për gjykime individësh, derdhin mbi ta të bëra e të pa bëra, vetëm për t'u shitur si revolucionarë e besnikë të Partisë, “kazanët” e informacioneve mbusheshin deri në derdhje dhe i dërgoheshin udhëheqjes më të lartë. Sot çdo hap i shpejtuar që mund të jetë bërë në aspektin e vlerësimit të një mase ndëshkimore i faturohet Enver Hoxhës dhe vetëm Enver Hoxhës. Kjo nuk është aspak e drejtë. Enver Hoxha nuk shprazte vendime nga lart, por mernte informacione e vlerësime kolegiale nga poshtë, që të studioheshin po kolegjisht nga lart. Çdo masë ndëshkimore është marrë në fund të fundit kolegjisht, prandaj fatura s'duhet prerë individualisht. Gjithësesi nxitja artificiale e luftës brenda llojit, brenda Partisë, ashpërsimi i luftës së klasave brenda saj, duhet pranuar, çoi në një farë konformizmi tepër të rrezikshëm në Parti, gjë që ishte në dëm të revolucionit. **Konformizmi është krimbi i tmerrshëm që e shkrinë edhe çelikut e guximit revolucionar, e kthen komunistin në një robot, i cili në fakt ka humbur çdo gjë prej komunisti, është kthyer në një njeri pa ideal, madje mund të thuhet pa frikë në një qenje antinjerëzore. Ka sot ish-komunistë të sferave të larta që i rehabilitojnë me zë të lartë të ndëshkuar të ndryshëm, por nuk thonë se kanë qenë po ata vetë që me zë të lartë patën kërkuar dënimin e tyre. Madje kanë qenë po këta njerëz të pafytyrë që bënë ligjin në emër të Partisë dhe i detyronin të vegjëlit të binin në kënetën e konformizmit.****

Së pesti, në dekadën e fundit të socializmit ndikuan për keq disa masa krejt të pastuduara ekonomike, siç ishte çështja mjaft e përfolur e tufëzimit të bagëtive. U nxit kjo masë nga karrierizmi i disa kuadrove, apo nga qëllimi i disa të tjerëve për të krijuar pakënaqësi në popull, kjo ha diskutime, por vetëm një gjë nuk ha diskutime: Edhe pse kjo masë në **thelb pati qëllime fisnike dhe u nis për mirë**, ajo nuk doli siç reklamohej se do të dilte. Për hir të realiteti populli ose u pyet formalisht, ose nuk u pyet fare. Masa e Partisë në këtë rast nuk është pa përgjegjësi. Mijëra e mijëra bagëti ose u therën, ose ngordhën. Pas kësaj mase të shpejtuar, që mund të konsiderohet gati fatale, gjëndja u këqësua së tepërmi. Shumë shpejt u ndie krizë mishi dhe asortimentesh të tjera blegtorale si në fshat e në qytet. Në kongresin e dhjetë të PPSH-së u tha shkarazi se Enver Hoxha fillimisht ka hezitur të mërrej kjo masë ekonomike - dhe kjo sipas shumë burimeve rezultoi e vërtetë – por nuk u tha si ndodhi, kush e nxiti, me çfarë qëllimi, dhe, në fund të fundit, përse nuk u korigjua kurrë gabimi? **Mund të mendohet se gabimi nuk u korigjua me urgjencë, sepse ai nuk e pati burimin nga**

poshtë, nuk qe inisiativë e popullit, por inisiativë e disa burokratëve nga lart, të cilët e nxitën këtë masë ose se nuk qenë largpamës, ose se ishin karrieristë e ëndërronin të ngjiteshin lart e më lart, ose ishin armiq dhe vepruan ashtu për të armiqësuar popullin me pushtetin. Për sa ndodhi në vitet tetëdhjetë nuk ishte faji i socializmit si sistem, por ishte faji i burokratëve që nuk i bënë aspak mirë llogaritë dhe ç'është më e keqja nuk patën guximin të thoshin se gabuan.

Gjithësesi një masë e parakohëshme nuk mund të zbehë politikat ekonomike të Partisë e pushtetit në afro 50 vjet socializëm, të cilat rezultuan pozitive e dhanë rezultate të larta. Kanë qenë këto politika të drejta ekonomike që ngritën një varg qytetesh industriale dhe siguruan punësimin e çdo shqiptari, që në kapitalizëm, qoftë edhe në vendet më të zhvilluara, nuk arrihet kurrë. Realiteti socialist duhet parë në kompleksin e vet. Të mbrojmë pozitiven sunduese dhe të shohim në sy edhe negativën, siç është i shumëpërfoluri tufëzim që çoi në tolona mishi e gjalpi e radhë vezësh e qumështi. Sot kundërshtarët tanë e shfrytëzojnë këtë masë të shpejtuar ekonomike për të denigruar socializmin në tërësi.

Disa të meta e gabime që janë vënë re në procesin e vështirë të ndërtimit socialist janë **megjithatë vetëm një pikë ujë në detin e arritjeve socialiste, por kundërshtarët tanë për qëllime politike pikën e ujit e bëjnë det e detin pikë uji.** Jo vetëm për një veprim të kritikueshëm, por për gjithçka, qoftë për socializmin si sistem, qoftë për liderin kryesor të revolucionit. **Ata luftojnë të zmadhojnë në pikë të errët deri në pakufi dhe madje gjithë dritën pozitive ta konsiderojnë errësirë deri në pa kufi.**

Të shohësh me syze të zeza vetëm disa hije në epokën e Enver Hoxhës, në të cilën u kryen transformime me vlera kolosale në shërbim të popullit do të thotë të ketë vdekur brenda teje njeriu dhe të jesh kthyer në një monstër. Mjerisht po shohim se mbi tokën tonë po hanë çorbë qensh shumë njerëz, të cilët megjithatë nuk mund të quhen njerëz, por disa qenie me fytyrë njeriu. Një lukuni e tërë qensh me fytyrë njeriu, ish të prekur nga reformat socialiste, po edhe inxhinierë e kryeinxhiniera, profesorë e doktor profesora, të pazotët për të denoncuar krimet e kapitalizmit, i janë sulur me tërbim socializmit, duke spekuluar si vagabondë politike me disa dobësi e të meta në procesin e tij. Dhe këtë e bëjnë më së shumti për t'iu servilosur sistemit të ri, ose më saktë, pushtetarëve. Kjo lukuni horrash shejtin e bën djall e djallin shejt. Një dijetar dhe poet kuban, Hoze Marti, thosh: **"Dy çlirimtarë latino-amerikanë janë të shejntë: Bolivari i Venezuelës dhe San Martini i Argjentinës. Këtyre u duhen falur gabimet, sepse të mirat që kanë bërë janë më të mëdha nga gabimet. Njerëzit nuk mund të jenë më perfektë se sa dielli, i cili djeg me të njëjtën dritë që ngroh. Dielli ka njolla. Mosmirënjohësit shohin e flasin vetëm për njollat ndërsa mirënjohësit flasin vetëm për dritën".**

S'ka më bukur se kaq e këto fjalë nuk duan koment.

Shokë dhe shoqe,

PKSH s'ka patur krahë hyjnorë të rrokë universin, por qysh 20 vjet më parë e në vijim ka luftuar me idealizëm dhe i ka thënë e para disa të vërteta që kërcënonin shoqërinë tonë. Ajo, duke shfrytëzuar ato mundësi shumë të vogla që i ka lejuar demokracia borgjeze, ka qenë e vetmja forcë politike në Shqipëri që ka ndier dhe paralajmëruar rreziqe të mëdha, që do të konkretizoheshin në tragjedinë e vitit '97. Pesë vjet para se të ndodhte tragjedia e pashembullt PKSH lëshoi thirrjen publike që shumëkush e mban mend: **"Shqiptarë, mos i**

lidhni sytë me shami të zezë para qendrave të votimit, sepse po t'i lidhni me shami të zezë, as qyqja s'do mund ta vajtojë fatin tuaj". PKSH ishte e vetmja forcë politike në Shqipëri që, edhe pse në ilegalitet, paralajmëroi dhe bëri thirrje publikisht: **"Shqiptarë, tërhiqni paratë nga firmat piramidale, ndryshe paçi veten më qafë"**. Mbi të gjitha, PKSH ishte e vetmja forcë politike në Shqipëri, e cila qysh në ditët e para të krijimit të saj, plot 20 vjet më parë, deklaroi me guxim se në Shqipëri po instalohet fashizmi. Dhe ky fashizëm edhe sot është gjallë e më gjallë. A nuk ishte fashizëm djegia e libravë si në kohën e Hitlerit? A nuk ishte fashizëm e përtej fashizmit shkatërrimi i gjithçkaje që ngritën duart e popullit për 50 vjet? A nuk ishte fashizëm shkatërrimi i të gjitha muzeve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në të gjitha qytetet e Shqipërisë? A nuk është fashizëm kryqëzata që vazhdon t'i fshijë të gjitha gjurmët e lirisë? Neonazizmi i sotëm ia ka kaluar edhe nazizmit të dikurshëm gjerman i cili mësynte të zhdukte çdo gjurmë nga jeta revolucionare e Ernest Telmanit. Edhe të vrarët e 21 Janarit 2011 për fashizëm flasin.

PKSH për 20 vjet me radhë ka pohuar pa hezitim se korrupsioni gjigand s'ka të bëjë me individë e segmente qeverisëse, s'ka të bëjë me fenomene të veçuara, po ai është në sistem, sepse veç të tjerave, vetë mjaft nga ligjet e ushqejnë atë. **"E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit"** thuhet në Kushtetutë, po ndër ne shteti dhe qeveria u ngjajnë organizatave mafioze, prandaj dhe nuk është zbatuar kurrë legjislacioni në fuqi për vjedhje e shpërdorime kur ato janë bërë prej bosëve në shtet e qeveri. **E një korrupsion në sistem s'ka forcë qeverisëse ta ndalojë, as makar ta zbusë, veç forcës për të shkatërruar sistemin, që mjerisht sot Shqipërisë i mungon.** Sot mjerisht ka edhe shokë komunistë që të keqen e sistemit kapitalist e shohin më shumë tek emëra të përveçëm pushtetarësh se sa tek vetë sistemi. Partia Komuniste është në radhë të parë kundër sistemit kapitalist e në të njëjtën kohë edhe emërave të përveçëm që e mbrojnë atë, ose, duke qenë të veshur me pushtet, spekulojnë në mënyrë kriminale në emër të sistemit. **Një gjë është e qartë si drita e diellit: Vetëm socializmi siguron pamundësinë për të bërë korrupsion, pse në këtë sistem veprojnë ligje të hekurta dhe procedura të hekurta që nuk të lejojnë të abuzosh, qofsh ti një punonjës i thjeshtë, qofsh ti një kryeministër apo president. Në këtë aspekt fytyra e socializmit është më e pastër e më e shkëlqyer se "fytyra" e diamantit.**

Ka plot 20 vjet që pozitarë dhe opozitarë u bien trumpetave për integrim në Europë. Shumë shtete ish komuniste e morën statusin e kandidatit për në Bashkimin European e u bënë anëtare të tij, ndërsa Shqipëria e humbi edhe këtë vit mundësinë. Për këtë pozita ia hedh fajin opozitës dhe opozita pozitës. Natyrisht humbja e shansit për të fituar statusin e kandidatit humbet kapitalizmi në Shqipëri disa miliona dollarë e disa privilegje të tjera, por nuk u humbet gjë kastave partiake e shtetërore. Përderisa pranojmë të vërtetën se korrupsioni është në sistem, duhet të pranojmë se bosët e korrupsionit, ata që janë në pushtet, nuk i zë fort meraku i statusit, sepse duke qenë jashtë Europës ndihen më të lirë për të ushtruar korrupsionin, ndërsa duke qenë brenda saj janë të detyruar të vihen sadopak nën kontrollin e saj, duke i humbur kështu pjesërisht disa fitime që burojnë nga korrupsioni. Partia Komuniste e dënoncon edhe këtë të vërtetë të hidhur e tok me të edhe demagogjinë e shpëlarë lidhur me interimin në Europë. Ne si komunistë Bashkimin European e shohim si bashkim të kapitalistëve për forcimin e kapitalizmit, ku pushtetin do ta kenë të mëdhenjtë dhe ku shtetet e vegjël do të jenë si ata fakirët që marrin asistencë.

Në rrethanat e një cunami të jashtëzakonshëm antikomunist, PKSH ka patur urtësinë të orientohet drejt në lidhjet e bashkëpunimin me partitë e tjera në vend. Në përgjithësi kemi

vepruar me pjekuri e **drejt** për një kohë dhe me **naivitet** për një kohë. **Nga ky kongres o duhet të dalim të bashkuar në një mendje, o të ndarë në dy mendje.** E themi këtë, sepse kohët e fundit në trupin e shëndoshë të Partisë na është zbuluar një plagë, të cilën o duhet ta shkulim, o plaga do të përhapet deri në shkatërrim të trupit tonë. Po kjo e fundit nuk do të ndodhë. Ne nuk do të lejojmë që lirin e trupit tonë të shatërrim me ferra. Ne jemi parti e pishtarëve që luftojmë të ndriçojmë udhën e popullit, jo parti e ferrave që i mbetemi popullit nëpër këmbë.

Shokë e shoqe,

Për 20 vjet me radhë ne e kemi drejtuar tehun e shpatës thujse vetëm nga e djathta ekstreme dhe këtu s'kemi gabuar, sepse mëkatet e saj dihen. Por ne si Parti Komuniste nuk jemi ndaluar fort seriozisht se çfarë po ndodh në kampin e ashtuquajtur të majtë për të bindur vetveten a është vërtetë i majtë, gjysmë i majtë, çerek i majtë, apo hiç i majtë dhe të majtë ka vetëm emërin?

Shokë të dashur, sipas konceptit leninist, **partitë nuk vlerësohen nga emrat që mbajnë, por nga veprat që kryejnë.** Sot edhe maskarai më i madh s'ka asnjë pengesë të shkojë në gjendjen civile dhe ta ndryshojë emrin nga Maksut në Diell. Po e bën vërtetë diell maskarain emri diell? Aspak. Kështu ndodh jo rallë edhe me partitë. Mund ta kesh emrin Parti Demokratike, Parti Socialiste, Parti Komuniste e në realitet të mos jesh as demokratike, as socialiste, as komuniste.

Ne do të dëshironim që kampi i majtë të mbetet i majtë, por kjo s'varej nga dëshira jonë e mirë. Partia e Punës u konvertua socialiste nëpërmjet një akti të djathtë më 12 qershor '91 në Kongresin e Partisë së Punës. Kjo ishte në fakt një tragjedi e paparashikuar, e paimagjinueshme më parë. Një parti plot 50 vjeçare brenda orës shkel mbi idealet e saj, mbi tërë rrugën e saj, mbi varret e bijve të saj. Përkundër kësaj tragjedie u organizua, ose më saktë, u rithemelua më 10 shtator 1991 Partia Komuniste. Këtë akt e diktuan rrethanat. Me t'u mbyllur Kongresi i Dhjetë pasi përfitoi gjithçka nga e kaluara, materiale e njerëzore, kjo parti, socialistja, organizon Kongresin e Parë dhe shpallet botërisht e distancuar nga Enver Hoxha dhe nga Partia e Punës, gjë që donte të thoshte se në fakt ajo distancohej nga plot një gjysëm shekulli luftë e punë, pra edhe nga tërë ato vepra madhështore të ndërtimit socialist.

Mjaftonte vetëm ky deklaram që Partia Komuniste të analizonte situatën për të ndarë apo jo kufijtë me këtë forcë politike, mirëpo ajo u ndodh në rrethana mjaft të ndërlikuara. Natyrisht ndikoi jashtëzakonisht shumë fakti se Partia Demokratike më shumë se sa parti u shfaq fillimisht si një lëvizje tepër e turbullt, ku vërshuan bashkëpunëtorë të fashizmit, ish komunistë, të burgosur politikë e jo politikë, me pak fjalë ajo u shfaq si një e djathtë ekstreme dhe u pa gjithashtu qartë se brenda saj kishte jo pak segmente fashiste. Në këtë situatë shumë të rëndë që u krijua në Shqipërinë që digjej, PKSH, duke qenë e nxjerrë edhe jashtë ligjit, vijoi ta mbështeste Partinë Socialiste dhe nuk mund të thuhet se gaboi **në pesë-gjashtë vitet e para.** Por duhet thënë se për një mijë e një arsye, me kalimin e kohës, këtë parti e kemi duruar shumë dhe pa e kuptuar jemi prekur disi nga verbërizimi, për të mos thënë revizionizmi. Ajo nuk mbeti një parti demokratike përparimtare siç mendonim ne se mund të bëhej.

Me të rimarrë pushtetin më 1997, edhe pse s'kish nevojë për koalicionë të imponuara, PS thirri në qëverit dhe e ndau pushtetin me djathtistë ekstremë, ish themelues dhe udhëheqës

të modelit fashist për disa vjet të Partisë Demokratike dhe i bëri ministra. Emrat e tyre dihen. Ne pothuajse nuk është se heshtëm, por nga zemra nuk e ndamë PS-në. Sot ata ministra janë prapë ministra, veçse me Sali Berishën.

Me të marrë pushtetin, në mënyrën hipokrite e demagogjike të pështirë, PS krijoi institutin e të përndjekurve politikë, sikur të mos që ajo parti që i kish përndjekur, sigurisht me të drejtë dhe në emër të popullit. Po ashtu me të bërë përçapjet e dyta të kthimit nga ana e Leka Zogut më 1997 në Shqipëri, PS jo vetëm i krijoi mundësi të vinte, por e priti edhe në aerodrom dhe kryetari i saj vajti i ra në gjunjë publikisht. Po kjo parti, duke qenë në pushtet, në vitin 2002 bëhet garant për rikthimin e Leka Zogut familjarisht në Shqipëri nga që më 1997 që detyruar të largohet pas skandalit që bëri me kërcënim armësh kur humbi referendumin për monarkinë. Po kjo parti, duke qenë në pushtet, në vitin 2003, voton një ligj të posaçëm për statusin e familjes mbretërore!!! Dhe jo vetëm kaq. Ajo i dha emrin e Ahmet Zogut bulevardit qendror të Tiranës dhe një spitali i dha emrin e Geraldinës.

Sigurisht kthimi i Leka Zogut në Shqipëri pritej, por nuk pritej që këtë mirëseardhje ta vuloste ish partia e komunistëve, nuk pritej që po ajo parti që e pati demaskuar për 50 vjet ta mbulonte me kurora lavdie. Mos pati gabuar 50 vjet? Jo, nuk pati gabuar. Ahmet Zogu ishte një anadollak, intrigant e vrasës i fshehtë, i ardhur në pushtet me ndihmën e serbëve, me kryengritje, por njëherësh shtypës i kryengritjes së Fierit, persekutor i komunistëve, mbrojtës i feudalëve, krejt i pazoti për të ndaluar gjakmarrjen, matrapaz pazaresh nga më të shëmtuarit, shitës i trojeve kombëtare si ato të Shën Naumit, tradhëtar i Atdheut e zhvatës i floririt të arkës kombëtare më 1939, kumarxhi i regjur që bëri vetëm kumar me fatet e kombit, mbret i vetëshpallur që nuk u njoh as në Angli si mbret kur u largua nga Atdheu, po u njoh thjeshtë si një refugjat, pa të drejtën që të merret me politikë. Atëherë përse i duhej dhënë status me ligj të veçantë familjes së tij? PS nuk e sqaroi këtë asnjëherë.

Me të ardhur Abaz Ermenji në Shqipëri, PS doli me një artikull partiak në gazetën “Zëri i Popullit” ku barazonte luftën e partizanëve me atë të ballistëve, kundër të cilit u ngrit Profesor doktor Xhemil Frashëri. Ne pothuajse heshtëm. Sapo personi në fjalë, i cili kish larë duart me gjak partizanësh, vdiq një ditë prej ditësh, kryetari i socialistëve, si një karagjoz politik, shkoi e u përkul para tij dhe ia stolisi arkivolin me lule. Ne pothuajse nuk heshtëm, por as det e tërmet nuk bëmë.

Me t’u larguar Fatos Nano nga posti partiak dhe marrjen e tij prej njërit prej neonazistëve më të zellshëm, i cili para 20 vjetësh ishte i pari shqiptar që doli publikisht për të rishikuar Enver Hoxhën, që thërriste: “Komunistët në litar, veteranët në hanxhar”, që çirrej më tej “Enveri si Hitleri e komunizmi si nazizmi”, që shkruante një libër të tërë për ta “argumentuar” Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare si luftë civile, që pëlliste miting më miting e qytet më qytet para turmave se Enver Hoxha ka qenë më i zi se pushtuesit romakë, bizantinë, serbë, turq, italianë, gjermanë, ne pothuajse nuk heshtëm, por nuk e bëmë alarmin e duhur dhe nuk morëm ndonjë vendim politik si Parti se cili do të ishte qëndrimi ynë kolektiv.

Me t’u afruar zgjedhjet e vitit 2009 në një natë të errët të 21 prillit, larg çdo syri, PS dhe PD bënë kompromisin e zi që zhvleftësonte totalisht presidentin e Republikës, Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe, nëpërmjet kodit zgjedhor, zhvleftësonte pluralizmin politik në Shqipëri me synimin djallëzor që në këtë vend të këndonin vetëm gjeli i PD-së dhe gjeli i PS-së, si dhe kryeministri të kish pothuajse kompetenca absolute, më të shumta se një perandor e një mbret në kohëra të shkuara. Ne nuk është se heshtëm, por zëri ynë megjithatë nuk që në lartësinë e duhur.

Me gjithë këto dhe shumë të zeza të tjera, ne e votonim Partinë Socialiste, duke e justifikuar votën në respekt të elektoratit. Dhe duhet pranuar se kemi gabuar. Kemi humbur 20 vjet për hir të elektoratit, në vend që të kërkonim që ky elektorat të gjente e të ecte në gjurmët e nderit dhe jo në gjurmët e një udhëheqjeje tradhëtare, antipopullore. Ajo vazhdoi të nxirrte me votat tona, sidomos në balotazh, deputetë, ne nuk fitonim nga votat e saj qoftë edhe një këshilltar në ndonjë komunë a bashki. Në Kongresin e 13-të mbajtur në vitin 2002 është e vërtetë se u ndalëm gjatë në djathtizmin e PS, dhe në raportin e tij gjenden edhe këto rreshta: **”Nëse ky kongres (i trembëdhjeti) nuk arrinë t’i çjerrë maskën njëherë e mirë të majtës së rreme dhe të argumentojë, pa i lënë shteg asnjë iluzioni, se PS në program e në veprime, në teori e në praktikë ka vepruar djathtas dhe, ndryshimi i saj me PD qëndron vetëm në disa nuanca. Nëqoftëse do të formojmë bindjen e plotë se komunistët nuk i lidh asgjë ideologjike e programore me këtë forcë politike, sigurisht kjo do të ishte një bazë e fuqishme për të demaskuar e luftuar në të ardhmen demagogjinë dhe mashtrimin e të majtës së rreme”**. Por sa parà bën kur vazhdonim ta mbështesnim e ta votonim, edhe pse ajo s’u kujtua kurrë për ne. Për 8 vjet të PS në pushtet ne nuk ishim në lartësinë e opozitës. Dhe ky qëndrim negativ i yni është totalisht i pajustificueshëm.

Natën e 21 prillit 2009 ajo, në bashkëpunim me PD-në, siç e theksuam më lart, ajo hartoi një kod nazist zgjedhor, i cili de fakto e nxirrte PKSH-në jashtë ligjit. Ne e dënuam këtë pakt, e morëm vendimin e drejtë politik dhe i bojkotua ato zgjedhje. Ne e ngritëm zërin, por kush na dëgjoi? Askush. Absolutisht askush nuk u shqetësua që një partie të tërë ia dënuan të drejtën universale të votës. Dhe këtë të drejtë na e dënoi me vdekje Partia Socialiste, sepse në fakt kodin ia propozoi ajo Partisë Demokratike, të cilës i erdhi për shtat dhe e pranoi. Me këtë kod nazist dënimin maksimal e morri vetëm Partia Komuniste, e cila, duke qenë jashtë koalicioneve, s’kishte asnjë mundësi të realizonte kërkesat e parealizueshme të kodit për të hyrë në zgjedhje.

Në zgjedhjet vendore të këtij viti u rrezikuam prapë të mos marrim pjesë, përjashto ato komuna e bashki ku kishim këshilltarë. Siç dihet vendosëm të hynim pjesërisht në zgjedhje bazuar në këshilltarët që kishim dhe me shpresën për të siguruar ndonjë mandat nga ish këshilltarë të partive të tjera. Diku gjetëm, po për çudi na dolën kundër komisionerët socialistë, të cilët, duke shkelur ligjin, përdorën kartonat e nuk mundëm të çajmë. Diku edhe mundëm të çajmë. Në orët e fundit falë sekretarit të KQ për çështjet e pushtetit shokut Xhamal Shehu siguruam një mandat edhe brenda në Tiranë.

Duke hyrë në këtë fushatë zgjedhore në kryeqytet, ne ndjemë gëzimin e ligjshëm, që edhe PKSH në Tiranë po ndihej për mbijetesë, pa ditur se po hynim në legjendë, pa ditur se kundër nesh Partia Socialiste do të ngrinte një kombinat me baltë e thashetheme, aq më tepër, pa ditur se edhe midis nesh do të kishte probleme, sepse disa shokë në dy-tri rrethe në vend që të qanin hallin e kandidatit të tyre dhe të punonin që Partia të merrte sa më shumë vota dinjiteti, në mënyrën më të padrejtë e më të shëmtuar qanin hallin e kandidatit socialist, madje disa ikën fare nga Partia. Në fakt ata ishin të ikur, sepse qëndronin si “kolonë e pestë” ndër ne. **Mjerisht ende Partia nuk është pastruar nga këtë njerëz. Ajo duhet të pastrohet me urgjencën më të madhe dhe pa pikën e dhimbjes. Ashtu si në një vathë nuk mund të qëndrojnë sëbashku edhe delet, edhe ujqit, po ashtu në një parti nuk mund të qëndrojnë sëbashku edhe komunistët, edhe socialdemokratët. Partia Komuniste mund të qëndrojë në këmbë si monument çeliku e t’u rezistojë stuhive vetëm kur është një organizëm i bashkuar komunistësh të çeliktë, vetëm kur ndahet**

njëherë e mirë nga socialdemokracia, më konkretisht nga Partia Socialiste dhe sanitarët e saj. Partia Komuniste ka tjetër mision: Ta fshijë me fshesë Partinë Socialiste e çdo parti tjetër si ajo, të fshijë me fshesë borgjezinë dhe kastat e saj.

Ne jemi komunistë, jo myslymanë fundamentalistë që rrokin thikat dhe armët për të vrarë çdo njeri që atakon profetin Muhamed. Partia Socialiste nuk është as profeti Muhamed dhe as Jezu Krishti, që ne u dashka t'u falemi. Ajo nuk është as populli, që na predikojnë disa, që mjerisht s'kanë kuptuar as se ç'do të thotë as Marks e as popull. **Si është e mundur që disa shokë të quajnë të gabuar pjesëmarrjen e shokëve të Tiranës në zgjedhje në të dy nivelet kur ky ishte vendimi i KQ dhe kur në Tiranë në katër fushata zgjedhore Tirana ka marrë pjesë në të dy nivelet dhe s'është bërë kurrëfarë zhurme? Vetëm e vetëm pse humbi socialisti Edi Rama dhe fitoi demokrati Basha?** Po Partinë Komuniste **nuk e lidh asgjë, asgjë, asgjë** as me socialistin Rama, as me demokratin Basha. Që të dy janë kundërshtarët tanë. Ne jemi edhe kundër njërit edhe kundër tjetrit, ndryshe s'do ishim komunistë por horra revizionistë. Që të mos fitonte demokrati, fare mirë elektorati socialist mund të votonte kandidatin komunist! Kandidati jonë nuk ishte yll karvani, por ama ai kishte vlerë shumë më tepër se një nazist, një njeri pa ndonjë kontribut për shoqërinë shqiptare. Nëqoftëse elektorati socialist do të votonte kandidatin komunist, ai demokrati do të mernte udhën për Bathore. Elektorati socialist gaboi vetë dhe pastë veten më qafë! Nga ana tjetër, fall do të hidhnim ne? Socialistët 4 vjet më parë kishin marrë 23 mijë vota më tepër. Më tej akoma: PS në Tiranë humbi 7 minibashki. Mos edhe për këtë e ka fajin Partia Komuniste? Më tej dhe më tej akoma: PS ka humbur kryesinë e këshillave në plot 11 qarqe vetëm e vetëm se njerëzit e saj dhe aleatët e saj shitën votat. Mos vallë edhe për këto humbje e ka fajin Partia Komuniste?

Dhe më në fund çfarë borxhi i kemi ne kësaj partie? Ne s'kemi borxhe ndaj saj. Ajo ka borxhe ndaj nesh. Në fushatat zgjedhore të paktën ajo 20-25 mijë vota i ka marrë prej nesh, të cilat të mbledhura së bashku bëjnë afro 500 mijë vota. Ne prej saj s'kemi marrë kurrë qoftë edhe një "faleminderit". Ne prej saj s'kemi fituar edhe një të punësuar si pastruese korridoresh në 20 vjet, **ndërsa partitë e tjera aleate janë rritur thjeshtë** nga punësimi që u siguronte anëtarëve të tyre PS, se për bukën e fëmijëve njerëzit kanë pasë qenë regjistruar edhe në partitë fashiste, jo më të mos regjistroheshin, fjala vjen, në Demokracinë Sociale. Për PS kemi marrë vetëm përçmim e deri tallje, apo fyerje si ato të një lope mashkull, ish ministër, si L. Hajdaraga një hajdut pilafi e shitës armësh, që del e thotë se "PKSH është një grumbull pleqsh të rrjedhur".

Mbi të gjitha e mbi të gjitha në zgjedhjet e 8 majit 2011 ne ia shtrimë dorën asaj për koalicion. Por ajo preferoi të lidhej në koalicion me partinë pa anëtarë të një gangsteri antikomunist i quajtur Spartak Ngjela, me partinë e ish terroristëve të Postribës së Malësisë së Madhe, si dhe me partinë zogiste të Kurt Kolës, bazhibozikët e së cilës nën komandën e Bilal Kolës, njeriut që i kërkoi leje Abaz Kupit (e ky s'ia dha) të vristë në pabesi Enver Hoxhën në dhjetor të vitit 1943 në Shengjergj të Tiranës, njeriut që e lau në gjak Brigadën e Pestë Sulmuese kur kaloi në Veri, njeriut që në postin e nënkryetarit të Komitetit të Maleve ka firmosur vrasjen e shtatë Heronjve të Popullit vetëm në Mirditë, që nga Bardhok Biba, Katër Heroinat e deri te Ndrec Ndue Gjoka.

Ne, komunistëve patriotë, na pikon zemra gjak që ish Partia e veteranëve të lirisë dhe e heronjve e heroinave të ndërtimit, për të cilën ishim gati të vdisnim me këngë në gojë në fushat e luftës, degjeneroi deri në këtë shkallë të patolerushme. Por kjo nuk është përgjegjësia e jonë. Nuk është as përgjegjësia jonë kur më 14 e 15 maj turmat e

fantaksura na u kujtuan pas 20 vjetësh se paska Parti Komuniste dhe hodhën parulla të modelit nazist para selisë së tyre kundër komunistëve. Ka 20 vjet që disa trumykur socialistë na thonë: Çfarë, ju komunistët do merni pjesë në zgjedhje? Por ju kështu favorizoni Berishën! Sali Berishën e ringritën në pushtet ata dhe jo ne, me Sali Berishën lidhin marrëveshje politike ata dhe jo ne, me programin e djathtë të Sali Berishës u bashuan ata dhe jo ne, duke futur para pak ditësh në program deri martesat e homoseksualëve. E duke barazuar veteranët e lirisë me të persekutuarit politikë. Ata shiten si europianë të kulluar, por duke mos pranuar asnjë takim qoftë edhe për kortezi me PKS, asnjë aleancë, në fakt janë kundëreuropianë. PKS ndodhet brenda ligjit sipas ligjeve të Europës, jo sipas vullnetit demokrat e socialist që dikur na nxorrën jashtë ligjit. Përse këta “trima” u tremben edhe vetë ligjeve të Europës dhe dridhen të bashkëpunojnë me një parti të ligjshme, apo të bëjnë një ftesë kortezie në kongresin e djeshëm ku ish ftuar edhe ujku, edhe derri?

PKS hyn në zgjedje si forcë e pavarur politike për të shprehur alternativën e saj, ndryshe ajo vdes dhe po të vdes asnjëra nga partitë borgjese nuk na e hedh një grusht dhë mbi varr. Ne duhet të lozim rolin e **faktorit politik** dhe do ta luajmë atë. Nuk është se në zgjedhjet e 8 majit në Tiranë ne fituam ndonjë gjë të madhe, **por dhamë sinjalin se mund të jemi një faktor politik**. Dhe në fakt në këto zgjedhje Partia Komuniste fitoi politikisht. Fituam politikisht, sepse treguam se nuk jemi bisht i partive të borgjezisë, por forcë politike e pavarur. Kjo është vlerësuar nga dhjetra njerëz të arësyeshëm. Nuk është vlerësuar vetëm nga një masë e veçantë tifozësh të sëmurë socialistë, të cilët na konsiderojnë ne komunistëve, ashtu si Baronët, një masë skllëvërisht zezakë, që duhet të votojmë vetëm për ata. Por ne s’jemi skllëvër, ne jemi luftëtarë të çlirimit të popullit prej borgjezisë e kapitalizmit. **Ne, komunistët kemi qenë e do të jemi jo për ndryshimin e kuajve të karrocave, por për ndryshimin e sistemit, për t’i varrosur kuajt e kapitalizmit tok me karrocën e tyre, për triumfin e socializmit dhe komunizmit.**

Shokë e shoqe,

Ne jemi bij të këtij vendi që nuk është jashtë krizës. Ai është në krizë për të gjithë. Nuk është në krizë vetëm për kisha e xhami. Janë shkatërruar qindra e mijëra vepra dhe objekte industriale, por janë ndërtuar 873 xhami, 747 kisha dhe një sinagogë. Ndërkaq vendi është i zhytur edhe në borxhe të brendshme e të jashtme. Shqipëria e ditëve tona, sipas të dhënave zyrtare, ka rreth 900 miliardë lekë borxhe të brendshme e të jashtëme. Borxhet, siç e pamë, çuan vende më të zhvilluara në prag të katastrofës, jo më të mos çojë një ekonomi në reaminacion si e jona. Afrika sot shpenzon më shumë për shlyerjen e borxheve se për nevojat më të ngutshme të saj. Për disa vjet ajo mori nga perëndimi 540 miliardë dollarë borxhe dhe, vini re, ka shlyer 550 miliardë, pra 10 miliardë më tepër, por i mbetet për të paguar akoma edhe 293 miliardë të tjerë, të cilët rriten dhe miliardat për shlyerje shtohen. E njëjta gjë do të ndodhë edhe me Shqipërinë. Do të shtohen miliardat që nuk do t’i paguajnë miliardet e Partisë Demokratike dhe asaj Socialiste, por popullit ynë i varfër. Ka ardhur momenti të ndezim pishtarët për një popull në errësirë që nuk di ku shkon. Instrumentet e reja financiare që projekton Europa e vjetër s’mund ta shpëtojnë nga kriza as Greqinë, as Italinë, as Spanjën, as Portugalinë dhe ca më tepër Shqipërinë. As vetë Europa s’mund të shpëtojë duke i dhënë borxh vetvetes me borxhet që shpreson të marrë nga Kina si superfuqi ekonomike. Ne si Parti Komuniste duhet të mendojmë seriozisht e të veprojmë heroikisht për të larë borxhin tonë ndaj popullit. Padyshim, do të na duhen sakrificat mbinjerëzore për të kapërcyer barrikatadën e zeza që kemi përpara. Të shumta janë këto të zeza barrikada. Po përmendim vetëm dy ndër të shumtat.

E para, letërsia e zezë e helmit njerëzor. Termi “letërsi e zezë” ndoshta po përmendet për herë të parë në këtë kongres. Jo se dikush nga ne ka bërë ndonjë shpikje, por se letërsia e zezë tashme është një fenomen i ditës, të cilin e ndeshim që nga mëngjesi në darkë, në gazeta, në libra, në drama e komedi. Vetëm nga Tirana shpërndahen e nisen çdo ditë 800 faqe gazetash. Në të gjitha derdhet papushim murtajë kundër komunizmit, ideve komuniste dhe Enver Hoxhës. Vetëm në një muaj i bie që shqiptarit t’i shkojnë për shkatërrim të trurit 24 mijë e tetëqind faqe gazete. Po t’u shtosh këtyre edhe qindra faqe revistash dhe qindra emisione televizive që buçasin gjatë gjithë 24 orëve, arsenali propagandistik me helm special radioaktiv rezulton shumë i madh. Po qindra e mijëra libra, që në masën 95 për qind janë të nxira me antikomunizëm? Në pararojë të kësaj letërsie të zezë qëndron letërsia e burgjeve, e cila synon ta paraqes Shqipërinë para brezit të ri e para botës një burg të popullit. Kjo letërsi e zezë s’pati ekzistuar më parë në Shqipëri, as në kohën e monarkisë. Ajo lindi dhe zuri të rritet si një gjarpër me mijëra kokë në vitet nëntëdhjetë. Sot ajo ka marrë përmasa të paimagjinueshme. Helmi i saj po derdhet si shi pambarim në trutë e njerëzve. Letërsia e zezë, qoftë ajo letrare, qoftë ajo politike e publicistike, nuk përfill kurrëfarë të vërtete historike, kurrëfarë realizmi. Kudo të zë syri banda historianësh antihistorikë e banda letrarësh që çdo të kuqe e të bardhë e paraqesin të zezë. Mjaft shkrimtarë të ish realizmit socialist janë kthyer në apologetët më të poshtër të letërsisë së zezë, servilë të një regjimi të zi, të cilët të kujtojnë Gogolin rus, që në fillim të karrierës letrare u bë i famshëm e i njohur në mbarë botën me romanin “Shpirtra të vdekur”, por me vonë u shit tek paratë e Carit dhe, në shërbim të tij, arriti deri atje sa të shkruaj se muzhikut rus i bën dëm shkolla. Në atë kohë jetonte e luftonte një Belinski i madh që ia vinte kujtdo kufirin tek thana. Ne sot nuk kemi një Belinski shqiptar, por të gjithë bashkë mund të bëjmë atë që duhet bërë kundër letërsisë së zezë, pasojat e rrezikshme të së cilës nuk mund të nënvleftësohen. Ne do t’u kundërvihemi me ato mundësi e mjete që kemi.

E dyta, mentaliteti i ndërgjegjes së zezë të një mase të madhe ish kuadrosh e ish komunistësh, të cilët të përqendruar tashmë në barrikadën e zezë socialdemokrate, është kthyer rreziku më çoroditës, sidomos për brezin e ri. Ata tani thonë se komunistët s’kanë të ardhme, se vota për ta shkon kot, se tani është kohë tjetër. 20 vjet më parë ishin 170 mijë komunistë. Supozojmë se kanë vdekur 70 mijë, por kanë mbetur 100 mijë. Dhe këta 100 mijë që në gjuhën e poetit thuhej “Se ne jemi 100 mijë komisarë, që Dielli i komunizmit na ka larë” sot nga 100 mijë komisarë të kuq mund të thuhet se mjaft prej tyre janë konvertuar në komisarë të zinj, të cilët janë më të rrezikshëm se antikomunistët tradicionalë, sepse besohen më lehtësisht nga turma. Shorti i keq na ra të ndeshemi edhe me këtë masë të pamoralshme që dikur na bënte moral komunist.

Shokë e shoqe,

Ne mund t’i biem rruzullit tokësor tej për tej e rreth e rreth, por, në fund të fundit, shtrohet pyetja e të gjitha pyetjeve: Çdo të bëjë e çfare sfidash do të përballojë pas këtij Kongresi Partia Komuniste, cili do të jetë objektivi i saj më i afërt dhe si mund ta realizojë atë?

Padyshim objektivi ynë më i afërt është të ngjitemi **në lartësinë e faktorit politik në vend** dhe në zgjedhjet parlamentare të vitit 2013 të sigurojmë **pjesëmarrjen e Partisë në parlament. Jo se kjo pjesëmarrje e komunistëve i siguron popullit pushtetin, por se komunistët sigurojnë një tribunë për t’i bërë thirrje popullit të marrë në duar fatet e tij.** Po mund të arrihet me të vërtetë ky objektivi duke marrë pjesë në zgjedhje, ndryshe nga çdo parti tjetër, jashtë çdo koalicioni? E kemi thënë e stërthënë se PKSH nuk është kundër marrëveshjeve e koalicioneve, por kur nuk ekziston asnjë mundësi për koalicion, mos duhet

të ngremë duart përpjetë e të dorëzohemi në mënyrën më të shëmtuar? Jo, nuk mund ta bëjmë këtë. Kjo mundësi, të paktën në masën 99,99 për qind, ka vdekur. E themi këtë, sepse i ashtuquajturimi formacion i majtë do të na pranonte në koalicion vetëm me një kusht: Të distancohemi nga Enver Hoxha dhe Partia e Punës. Pra, de fakto të jemi një parti komuniste e vdekur, ndërsa de jure një turmë e verbër e debile për të çuar vetëm ujë në mullirin e borgjezisë. Nëqoftëse mundësia e koalicionit pa kushte do të krijohet, Partia do të marrë vendimin e duhur. Prandaj, sot për sot, na mbetet vetëm një rrugë: **të mbështetemi në forcat tona dhe të punojmë me faza e drejtime.**

Drejtimi i parë: Të marrim në duar iniciativën dhe të mos e lëshojmë nga duart. Kush ka iniciativën, ka fitoren. Sikur vetëm pak ta lëshonte Enver Hoxha nga duart iniciativën në kohën e luftës s'do kish kurrësesi fitore. Pa iniciativë strategjike as Stalingradi s'do të shënonte kthesën që shënoi. Të mos vonojmë, të ndezim fillimisht shkëndinë e aksioneve, sepse nga shkëndia lind zjarri i madh. Po nuk dolëm me kërkesat tona të qarta në popull, po nuk njohëm me alternativën tonë çdo shqiptar, po nuk u përleshëm para dyerve të bashkive trup me trup me xhandarët e borgjezisë, po nuk ecëm me moton "O me popullin për popullin, o me vdekjen kundër vdekjes" brezat do të na pështyjnë mbi varr. Më i pari e më frontali i aksioneve ka qenë e mbetet hyrja në popull. Dhe së pari mu atje, në Shqipërinë tjetër, ku përqëndrohen kronikat më realiste të kohës, ato të gazetarit Marin Mema.

Duke filluar nga janari i vitit 2012 Komiteti Qëndror bashkë me komitetet e Partisë së rretheve të organizojë shtabet e shtegtimit fshat më fshat e lagje më lagje për të çuar derë më derë alternativën komuniste, e cila duhet të hartohet e të konsultohet edhe me ekonomistë të aftë, që nuk mungojnë po t'i kërkojmë. Grupet e shtegtimit të jenë të vogla, me dy-tre vetë, njeri prej tyre mundësisht anëtar i KQ. Në këto grupe të shkrihen edhe shokët anëtarë të Byrosë Politike që do të dalin nga ky kongres e në radhë të parë Kryetari i Partisë që do të zgjidhet. Duhet të pranojmë, shokë, se ca nga mungesa e financës e ca nga planifikimi disi burokratik i punës, si këtu në qënder e si në bazë, jemi zënë robër nga burokratizmi, në vitet midis dy kongreseve vetëm sekretariati ka harxhuar 240 ditë mbledhje, shtojë këtyre mbledhjet e Byrosë Politike, të Komitetit Qëndror, shtojë dhe disa mbledhje të tjera me kryetarët e rretheve dhe sekretarët organizativë e të propagandës, dalin si tepër shumë ditë të harxhuara me mbledhje. Në situatën që ndodhet Partia, nëqoftëse nuk do të jepet shembulli qysh nga Kryetari i Partisë, i cili nga 365 ditë të vitit, të paktën 200 ditë duhet t'i kalojë në fshatra e qytete jashtë Tiranës, sidomos në fshatra, të mos mendohet se Partia do të bëjë hapa përpara. Nuk mund të ndërtojmë Parti të fortë pa vajtur me kalë e më këmbë aty ku nuk shkon as makina e s'ka dritë elektrike që prej 10 vjetësh, siç ndodh në Currajt e Epërm, as pa shkelur malësitë e Dukagjinit në Shkodër e ato të Kurveleshit, Zagorisë e Korçës në Jug, pa shkelur me këmbët tona fushat e malet. Mjerisht në pesë vjet është organizuar vetëm një takim me popullin e simpatizantët në një zonë të Myzeqesë. Nuk mund të ndërtojmë Parti të fortë në qoftëse anëtarë i Komitetit Qëndror këtë besim të Partisë e mbanë sa për stoli e nuk jep asnjë kontribut konkret, siç edhe ka ndodhur me disa shokë. Nuk mund të ndërtojmë parti të fortë nëqoftëse të gjithë anëtarët e KQ nuk ngarkohen me detyra e nuk u kërkohet llogari në forum. Nuk mund të ndërtojmë parti të fortë nëqoftëse disave u jepen shumë funksione, sepse koha ka provuar që nuk mund t'i kryejnë. Nuk do të mund të fitojmë besimin e popullit, jo vetëm pa qenë pranë tij, por edhe pa patur zotësinë e ndikimit pozitiv kur je pranë tij. Le të jetë, pra, më së shumti zyra jonë në shtëpinë e popullit. Atje është elektorati ynë, i cili duhet kërkuar e gjetur me mundim ashtu si gjurmuesit e diamanteve. Po nuk bëjmë këtë nuk kemi zbatuar porosinë e Enver Hoxhës: **"Komunisti duhet të jetë i lidhur ngushtë me masat, të dëgjojë me vëmendje e respekt zërin e tyre,**

të jetojë e të punojë me masat, të njohë pulsën e hallet e tyre, të qëndrojnë në krye të masave e t'i udhëheqë ato”.

Drejtimi i dytë: Të përqëndrojmë si asnjëherë tjetër vëmendjen tek organizata e rinisë komuniste “Qemal Stafa”. Ajo ka funksionuar qysh më 5 maj 1992, por ca për punën tonë të dobët, ca nga propaganda antikomuniste çoroditëse, e ca nga klima e rëndë e papunësisë, ajo s’ka qenë gjithmonë e qëndrueshme. **Forcimi i saj mbetet njëri ndër problemet më urgjente e më jetike për ripërtëritjen e Partisë.** Këtë frazë e kemi cituar edhe herë të tjera, por ajo ka mbetur vetëm frazë. Lufta që vjen nuk do fraza, do ushtarë. Ne qysh sot duhet të afrojmë në forumin më të lartë shokë të rinisë dhe ta kemi si objektiv që pas dy vjetësh të paktën 50 për qind e kryetarëve nëpër rrethe të jenë me moshë të re, po nuk bëjmë këtë s’kemi bërë asgjë. Vitin e ardhshëm organizata e Rinisë Komuniste “Qemal Stafa”, më 5 maj 2012 mbush 20 vjet nga krijimi i saj. Qysh sot duhet menduar për çka i takon asaj të organizojë në 5 majin e vitit tjetër.

Kërkesën e bërë në Komitetin Qendror që çdo anëtar i tij të afronte në Parti një deri në dy të rinj për fat të keq e hëngri macja e Kavajës për iftar. Nga i gjithë Komiteti Qëndror vetëm pesë shokë kanë afruar në Parti djemtë ose të afërm të tyre. Kjo sepse jo të gjithë shokët e KQ e ndiejnë përgjegjësinë e tyre dhe i janë mirënjohës Kongresit për besimin e madh që i ka dhënë. Justifikimet janë ves i të çmobilizuarve ng veprimi. Është e vërtetë që cunami antikomunist në Shqipëri është i tmerrshëm, por nuk është e vërtetë se s’ka asnjë rrugëdalje. Në daç besoni në daç mos besoni, kandidati komunist për Bashkinë e Tiranës mund të kishte dalë me 100 apo e shumta me 200 vota në zgjedhjet e 8 majit nëqoftëse një kontigjent të rinjsh universitarë e të papunë nuk do ta kishin mbështetur. Ky qëndrim i disa të rinjve ka qenë tepër befasues për ne në zgjedhjet e Majit. Rinia, për shumë arsye, është vërtet e çoroditur, por jo sa e bëjmë ne. Që të mos e çojmë Partinë tonë me duart tona në varreza, ne duhet të ndërtojmë strategjinë e duhur të veçantë në punën me rininë komuniste. Me shpirt militant e fantazi krijuese janë mundësitë për të çuar fjalën tonë në gjimnaze e fakultete universitare, gjithkund ku ka të rinj. Ne duhet të shohim mundësinë e kurseve të shkurta në rang qarku për edukimin komunist të rinisë, organizimin e kampingjeve modeste dimërore e verore, aktivizimin e tyre në ekskursione, pajisjen e tyre me shenja të veçanta simbolike, dërgimin e tyre me prioritet në veprimtaritë komuniste ndërkombetare etj. Ne duhet të çojmë mesazhe të mençura nëpër shkolla të mesme e universitete, që ajo të kuptojë pse borgjezia e joshë për të hyrë në portën e ferrit e pse duhet ta braktisë atë për të kaluar në portën e diellit. Qysh atë orë kur rinia komuniste të dalë në fushë të majdanit si lëvizje e gjallë dhe me një zë të ri, siç del rinia komuniste greke, siç dalin miliona të rinj nëpër botë, kini për të parë se çfarë rritje e autoritet do të ketë Partia. Të ecim, pra me parullën e kuqe: “Me rininë rigjallërojmë Partinë, me Partinë shpëtojmë Shqipërinë”.

Po nuk bëjmë këtë nuk kemi zbatuar porosinë e Enver Hoxhës: **“Komunisti duhet të jetë krijues... në përshtatje me kushtet në të cilat vepron”**, aq më tepër thirrjen e tij të shumënjohur **“Rinia i jep Atdheut jetë e gjallëri, Partisë gjakun e ri”**.

Drejtimi i tretë: Koha ka vërtetuar se një parti komuniste i duhen anëtarë me bindje. Duke perifrastuar atë thënien e shumënjohur të Leninit se pa teori revolucionare s’ka parti revolucionare, do të ishte e drejtë të thoshim vetë thelbin e saj se pa bindje komuniste s’do të kishte kurrë parti të vërtetë komuniste. Thelbi i të gjithë thelbeve qëndron në atë që teoria të kthehet në bindje absolute, ose, siç theksonte Enver Hoxha, të bëhet mish e gjak. Nuk mjafton vetëm ta njohësh teorinë, Teorinë komuniste e di edhe Papa i Romës, por ai e di që t’i kundërvihet. Buharini mbahej si njëri ndër teoricienët në Partinë Bolshevike, çmohej nga

vetë Lenini, por po Lenini megjithatë nuk e përkufizonte si marksist të formuar. Teorinë e njohnin mirë edhe pedagogët tanë të Shkollës së Partisë “Vladimir Illiç Lenini”, ama koha provoi megjithatë se nuk ishin aspak komunistë të bindur dhe e drodhën bishtin si majmunët sapo ndienë stuhinë që vinte. Bindja nuk janë çështje ndjenjash e moshe. Bindjet janë dielli që nuk shuhet. Kur Qemal Stafa pohoi me trimëri para gjyqit: ”Jam komunist i bindur”, nuk bëri shou, por tha një të vërtetë, e cila u provua edhe para vdekjes. Mijëra komunistë që konvertuan në demokratë e socialistë me përmbysjen e sistemit dhanë provën e padiskutueshme se s’kishin qenë komunistë me bindje të thellë, se bindjet komuniste nuk u qenë bërë mish e gjak, se në këtë mish e gjak nuk rronte dielli i bindjes që nuk shuhet, por kandili i zbehtë që shuhet nga era më e lehtë. Çdo anëtar i Partisë Komuniste duhet të njohë si fytyrën e nënës e babait, vëllait e motrës programin e Partisë, vijën e saj marksiste-leniniste, vendimet e saj dhe të jetë thellësisht i bindur për t’i zbatuar ato. Komunisti pa bindje në kauzën e vet është si pema e shkullur që lumi i turbullt i kohës e përplas brigjeve. Ne për 20 vjet me radhë kemi bërë punë fisnike që kemi mbajtur zjarrin e idealeve komuniste ndezur, por ne nuk jemi sa për ta mbajtur atë ndezur, por për të bindur popullin së shpëtimi i tij nuk vjen duke ndërruar kuajt e karrocës, por, ashtu siç thamë më lart, duke e përmbysur këtë sistem mizor dhe duke vendosur pushtetin socialist të popullit. Teoricienët e sotëm borgjezë e pranojnë kritikën e Marksit ndaj kapitalizmit, bile edhe atë të Leninit ndaj imperializmit, por shtojnë ata se Marksi e Lenini i përkasin të kaluarës. Ne me kulturë teorike e të bindur në kauzën tonë kemi për mision të pohojmë në nivel shencor së Marksi e Lenini i përkasin të ardhmes. Po nuk bëmë këtë nuk kemi zbatuar porosinë e Enver Hoxhës: **”Anëtarët e Partisë sonë revolucionare duhet të jenë besnik ndaj mësimëve të marksizëm-leninizmit... të vendosur deri në vdekje për t’i shërbyer partisë e popullit në çdo moment e në çdo rrethanë”**.

Drejtimi i katërt: vite më parë Partia hodhi idenë për organizimin e komiteteve të punëtorëve e fshatarëve. Diçka u arrit në nja dy rrethe, por makina e veprimit “mbeti mbi shina”. Është koha të ristudiohet ky problem i rëndësishëm dhe, pas hartimit e miratimit të një platforme për ndërtimin dhe funksionimin e këtyre komiteveve, të merren masa energjike që ato të ngrihen pak e nga pak, qytet në qytet e fshat më fshat, në bërthama të vogla fillimisht, por me plane e strategji zmadhimi, synuar për krijimin e një fronti popullor përballë krimeve kapitaliste e të gjitha rreziqeve që kërcënojnë shoqërinë tonë të sotme. Borgjezia e metropoleve të mëdha botërore organizon në të gjitha shtetet e botës disa të ashtuquajtura lëvizje civile, i furnizon me parà që t’i përdorë për interesat e veta. Ju kujtohet e ashtuquajtura lëvizje “Mjaft”, e cila me pak veta, por me parà të madhe ardhur nga kompanitë e metropoleve bridhte andej-këndej gjoja si partizane e lëvizjes kundër korrupsionit. Në fakt ajo kishte marrë detyrë të luftojë Partinë Socialiste, që të humbiste në vitin 2005, që Fatos Nano të jepte dorëheqjen dhe vendin e tij ta zinte Edi Rama. Si e mbaroi këtë mision, kjo lëvizje u duk se u kthye në parti, po dhe kjo ishte një manovër, sepse kryetari i saj Erion Veliaj e la menjëherë partinë fantazëm “99” e vajti si ufo në PS. Kohët e fundit ka dalë edhe lëvizja “Kuç e zi”, e cila ashtu si Lëvizja “Mjaft” reklamohet si gjoja shumë patriotike, si shumë kombëtare, zhvillon manifestime deri në Amerikë dhe reklamohet se po lufton për kombin e unitetin kombëtar. Në qoftë ky qëllimi, ne e përshëndesim. Në qoftë manovër nga ato që fabrikohen nga jashtë do t’i dalë boja kuç e zi. Kjo lëvizje me shkëlqim flamujsh kuç e zi ka joshur shumë njërez me emër të mirë, por ne nuk mund të mos jemi skeptikë kur kryetari i saj deklaroi në një emision në Prizren se regjimi 50 vjeçar komunist kishte qenë antikombëtar. Ky deklarim nuk tregon në të vërtetë fytyrën e një patrioti. Ky deklarim zbulon në të vërtetë **fytyrën e një vagabondi antikombëtar**. Metroplet, si i veshin lëvizjet me maska të ndryshme kombëtare, për qëllime që e dinë ata, duan t’i përdorin si

dikur përdorte Patriarkana Shën Kozmanë më petk fetar, ndërsa qëllimi i të cilit ishte në të vërtetë përhapja e shkollës greke dhe greqizimi i gjysmës së Shqipërisë në Shkumbin e poshtë. Në tërë hapësirën tonë kombëtare deri më tani ka vetëm një lëvizje demokratike përparimtare, revolucionare: **Vetëvendosja** me liderin e saj **Albin Kurti**. E tillë do të dëshironim të ishte dhe ajo "Kuç e zi". E përsërisim: Po qe se kjo lëvizje do të rezultojë e pastër, komunistët do ta mbështesin sinqerisht. Tash për tash është herët të flasim. Britma kombëtare lëshuan edhe ballistët, bile shqiponjën, zhgabën siç e quanin, e vunë edhe mbi qeleshe, mirëpo një orë prej orësh, mu nën këtë qeleshe me zhgabë, u vunë në shërbim të nazistëve gjermanë për të vrarë partizanët e lirisë. Ne nga ana jonë duhet të organizojmë **lëvizjet tona të ndershme në popull e për popullin**. Kështu do të mundim të organizojmë të paktën në bazë qarku potesta e deri demonstrata. Organizimi i komiteteve popullore të punëtorëve dhe fshatarëve në bazë lagje e fshati, zhvillimi i jetës së tyre mbi baza programore të qarta e vizionare, kthimi i tyre gradualisht në një lëvizje të fuqishme popullore do të shënonte një nga arritjet më të mira e më historike të Partisë. Le të mbjellim pra me durim e mundim farën e lëvizjeve popullore dhe të ndjekim në vigjilencë të lartë synimet e errëta të lëvizjeve që fabrikojnë e paguajnë metropolet. Po nuk bëjmë këtë nuk kemi zbatuar porosinë e Enver Hoxhës: **"Çdo komunist duhet të paiset me një vigjilencë me të vërtetë revolucionare"**.

Drejtimi i pestë: Të arrijmë me çdo kusht një kthesë të vërtetë revolucionare për forcimin e disiplinës të cilën e kemi në një gjendje jo fort të kënaqëshme. Mosrespektimi i disiplinës komuniste na ka dëmtuar rëndë. Në Partinë tonë ka një dukuri që duhet të marrë fund. Merren vendime unanimisht në KQ, pa asnjë kundërshtim, pa asnjë vërejtje, pa asnjë debat, por disa shokë i harrojnë, ose bëjnë sikur i harrojnë dhe nuk i zbatojnë. Si aspekt më freskët është ai i pjesëmarrjes në dy nivelet në fushatat zgjedhore. Jo vetëm që disa rrethe shkojnë e marrin vendim mbi vendim pa pyetur fare, marrin pjesë në një nivel kur i kanë mundësitë të marrin në të dyja, por kanë guximin edhe të kërkojnë llogari në rolin e një vegje partish borgjeze për ata që zbatojnë vendimin. Rasti më i freskët është ai i kandidimit në Tiranë, që e përmendëm më lart. Për çfarë discipline komuniste mund të bëhet fjalë, për çfarë morali komunist mund të bëhet fjalë kur në radhët tona kanë penetruar e notojnë për shtatë palë qejfe si peshq të pa tru edhe socialdemokratë ideologjikisht të degjeneruar dhe ndonjë komitet partie i toleron në kundërshtim flagrant me politikën e Partisë, pa menduar se këta peshq, në dukje të parrezikshëm, nesër mund të kthehen në peshkaqenë për të shqyer Partinë?

Në këto pesë vjet disiplina jonë ka çaluar disi edhe për faktin se u bë bashkimi më 2006 dhe shpesh për të mos krijuar qejfmbetje kemi mbyllur sytë ndaj disa shokëve jo aktivë. Kjo praktikë tashmë duhet të marrë fund. **Disiplina e fortë buron nga një formim i fortë komunist**. Është mungesë e theksuar mosformimi komunist të ikësh nga partia si cub kur të duash e si të duash. Para 5 vjetësh, duke e shkelur pa asnjë shkak e arësye marrëveshjen e bërë për bashkimin e Partisë Komuniste dhe asaj të Punës në një të vetme, një grup shokësh, kryesisht nga ish Partia e Punës, dolën në vete. A kështu u mbroka komunizmi? **Kush është komunist bashkohet rreth idealeve si ah, pishat e lisat rreth maleve**. Të largohesh nga Partia pa asnjë arësye ideologjike e politike do të thotë të mos jesh njeri, jo më komunist patriot dhe t'i sjellësh dëm çështjes. Ata që ikin, shpesh kanë guximin të thonë se janë me Enver Hoxhën dhe se e mbrojnë atë, por në realitet këta emrin e Enver Hoxhës e përdorin vetëm sa për sy e faqe, si një ikonë. Atdheut tonë të dashur i është dashur gjithmonë një Parti e vetme Komuniste që të veprojë si sahat dhe me zembrek disiplinë të artë, siç veprohej gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare e më vonë, kur nuk kishte nga

ata trima që mund të iknin nga Partia kur të donin e si të donin. Të dezertoje nga Partia dje në luftë të priste ndëshkimi me plumb, siç të priste ndëshkimi me pranga në paqe. Ne jetojmë në rrethana krejt të tjera. Për ne nuk mbetet gjë tjetër vetëm se t'i mëshirojmë disa njërez pa moral komunist e njerëzor që largohen nga Partia pa asnjë shkak, siç kemi fisnikërinë t'u bëjmë thirrje personave të arësyeshëm që kanë reflektuar pozitivisht t'i bashkohen Partisë së vetme komuniste, sigurisht me kërkesat sipas statutit e me mirësinë e ndjesës.

Partia Komuniste sot është kompakte, e bashkuar rreth yllit të idealeve të saj. Ka disa njerëz jashtë Partisë që nuk janë të mirëinformuar dhe flasin ende për bashkim komunistësh!!! Po me kë të bashkohemi, me Ufot? Jashtë PKS-së nuk ndodhet parti tjetër veçse një fraksioni që u shkëput nga Partia e Punës më 2006 duke prerë në besë marrëveshjen e bashkimit. Këta individë të veçuar nuk përbëjnë aspak shqetësim për Partinë Komuniste, sepse as kanë qenë ndonjëherë anëtarë të saj dhe as mund të bëhen përderisa nuk e pranojnë disiplinën me elementare komuniste dhe nuk njohin parimet më elementare komuniste. Për ne sot shtrohet çështja që të jemi sa më unikë, sa më të bashkuar e të ndërgjegjshëm në të vërtetën e marksizëm-leninizmit, se vetëm me qartësi ideologjike e me disiplinë leniniste në zbatimin e detyrave mund t'i përballojmë të gjitha sfidat. Le të marrim pak vendime, aq sa na mbajnë shpatullat, por ato t'i zbatojmë me disiplinë. Kërkesat e saj doemos kërkojnë mundime, vuajtje, sakrifica, por ja që vetëm duke kaluar përmes mundimesh e vuajtjesh bëhemi njerëz, bëhemi komunistë. Vetëm duke rrahur hekurin bëhesh kovaç, thotë një fjalë e urtë franceze. Na shajnë, na përbuzin, na thonë nostalgjikë, na thonë utopistë, gati sa nuk na thonë se nuk jemi as njerëz, siç thoshin çifligarët amerikanë në vitet 1800 për zezakët. Ne me përkushtim legjendar e disiplinë legjendare mund t'u tregojmë këtyre apostujve të injorancës e pabesisë se jemi në gjendje ta mposhtim zotin e tyre bizantin e qëndrimin e tyre të poshtër bizantin, se jemi në gjendje ta kthejmë në vepër ëndrrën tonë, se jemi në gjendje të fitojmë. Ta ngremë, pra, disiplinën komuniste në shkallë më të lartë. Po nuk bëjmë këtë nuk kemi zbatuar porosinë e Enver Hoxhës: **"Komunistët duhet të jenë të pajisur me një disiplinë të çeliktë e të ndërgjegjshme, me një vullnet të hekurt për zbatimin e vijës së Partisë..."**.

Drejtimi i gjashtë: Lufta për një parti të pastër dhe demokraci të brendshme të pastër. Edhe në kongreset e mëparshëm kemi theksuar se cilësia e Partisë është sasi, ndërsa sasia nuk është kurdoherë cilësi. **Ne duhet të përjashtojmë sa më pak,** na mësonte Enver Hoxha, - **por derisa kemi pranuar pa kritere kurdoherë të shëndosha dhe deri sa këta të pranuar nuk kanë pastruar në veten e tyre të mëtat dhe gabimet, është më mirë t'i nxjerrim jashtë partisë se sa t'i mbajmë brenda dhe të na i krimbin të tjerët.** S'ka e s'mund të ketë Parti të shëndoshë e të pastër nëse brenda saj nuk qëndrojnë në harmoni demokracia dhe centralizmi, disiplina e lartë dhe militantizmi i zjarrtë. Nuk jemi parti në pushtet dhe s'mund të ndjekim të njëjtat praktika, kur, realisht, drejtuesit e partisë më shumë emëroheshin se sa zgjidheshin. Sot drejtuesit duhen zgjedhur nga një masë sa më e gjerë në konferenca e kongrese. Sa më e madhe masa që i zgjedh, aq më i fortë uniteti mes të zgjedhurit, dhe zgjedhësit dhe aq më e vogël është mundësia që forumet e ngushta të kthehen në shpella banditësh, siç ndodhte në kohën e Hrushovit kur hynin gjeneralët në mbledhjet e Byrosë Politike si kaubojsa me pistoleta dhe arrestonin anëtarët, sado të poshtër që ata mund të ishin. Ne duhet ta edukojmë Partinë me shpirtin më të gjerë demokratik, me frymën e debatit parimor në organizata e forume, por edhe me nënshtrimin e pakicës ndaj shumicës e zbatimin e vendimeve të marra kolegjisht me ndershmëri, militantizëm e disiplinë të lartë.

Demokraci në Parti do të thotë që në raste tepër të veçanta, kur pakica ka të drejtë e jo shumica, forumet më të larta ta marrin çështjen në analizë, që ajo të zgjidhet në favor të së drejtës. Demokraci në Parti do të thotë që anëtari i thjeshtë i Partisë t'ia bëjë vërejtjen në sy drejtuesit më të lartë, por gjithmonë në prezencën e tij, ashtu si drejtuesi më i lartë në rreth a në qendër t'i bindet argumentit, ose ta kundërshtojë me argument bindës. Demokraci në Parti do të thotë që të dëgjohet me respekt çdo zë nga poshtë, edhe kur ky mund të mos jetë i drejtë, por jo qëllimshëm për keq. Demokraci në Parti do të thotë, që çdo diskutim të bëhet i hapur në "mexhllis", që të mos u krijohet asnjë mundësi individëve meskinë e intrigantë të veprojnë në formë grupazhi e të intrigojnë në rrethe të ngushta kundër anëtarëve të thjeshtë apo shokëve drejtues në qendër e në bazë. Demokraci në Parti do të thotë që të japësh llogari për vete në radhë të parë, pastaj t'i kërkosh shokut dhe forumeve, qoftë ky edhe Komiteti Qëndror. Demokraci në Parti do të thotë që të kuptohet drejt se post i kryetarit të Partisë në rreth a në qendër nuk është institucion dhe s'mund e s'duhet lejuar të veprojnë si i tillë por nga ana tjetër i zgjedhuri duhet respektuar në të drejtën dhe në besimin e kompetencat që i janë dhënë. Demokraci në Parti do të thotë që as forumi më i lartë, Komiteti Qëndror, të mos ketë të drejta të pakufizuara, aq më tepër Byroja Politike, siç ndodhte në Partinë tonë të udhëhequr nga Ramiz Alia. Një Byro e ngushtë Politike vendosi pluralizmin politik në Shqipëri pa pyetur masën e partisë. Një Komitet i manipuluar Qendror shkel e flak tej kushtetutën e Republikës pa pyetur as deputetët e as popullin. Demokraci në Parti do të thotë që as kongresi të mos ketë të drejta të pakufizuara, domethënë të mos ndryshojë vijën politike dhe ideologjike të Partisë pa votën e gjithë anëtarëve të partisë, që të mos ndodhin tragjedi si ajo që ndodhi në Kongresin e dhjetë të PPSH kur kongresit iu dha padrejtësisht e drejta për të ekzekutuar me vdekje një parti 50 vjeçare. Pak më lart theksuam problemin tepër jetik të afrimit të rinisë në Parti. Duhet të krijojmë bindjen më të thellë se në një Parti ku nuk funksionon në shkallën më të lartë demokracia atë e braktis rinia, sepse ajo nga vetë natyra e saj nuk i pranon format e ngurta, të tejkaluara, ose atë që figurativisht quhet "diktatura e pleqërisë". Prandaj ta forcojmë demokracinë në Parti me ndjenjën e përgjegjësisë më të pastër komuniste, sepse vetëm kështu s'do të kemi rrjedhje, po vetëm prurje të reja dhe Partia do të bëhet e fuqishme e do të gjenerojë dritë si një hidrocentral vigan njerëzor. Po nuk bëjmë këtë nuk kemi zbatuar porosinë e Enver Hoxhës: "**Anëtari i Partisë duhet të karakterizohet nga një drejtësi e kulluar...**".

Drejtimi i shtatë: Ne jemi një parti zemrash heroike dhe anëtarët tanë meritojnë respekt. Ne u organizuam nga e para para 20 vjetësh për të mbajtur të ndezuar zjarrin e idealeve komuniste e për t'u angazhuar në një luftë të gjatë me synim rikthimin e pushtetit të humbur në duart e popullit. Partitë e tjera janë daulina, drita e të cilave nuk rron më shumë se pesë minuta. Po të flasim figurativisht ne i ngjajmë martirit më fisnik të njerëzimit, siç e ka quajtur Marksi Prometeun, i cili e vuri zjarrin në shërbim të njeriut. Edhe ne atë e kemi vetëm në shërbim të njeriut. S'ka qenë e lehtë për ata komunistë heroikë tropojanë që e mbajtën ndezur këtë zjarr në malet e Tropojës që prej 20 vjetësh, me militantë të tillë si Shaban Haxhia, Rexhep Shpati e burra të tjerë shtatlartë e kryelartë. Të bukura, të mahnitëshme janë peizazhet e Tropojës, por më të bukura e më të mahnitëshme janë zemrat dhe mendjet e komunistëve të saj. Sigurisht s'ka qenë e lehtë as për ata që e mbajtën Partinë në këmbë gjatë ilegalitetit në qytetin e Shkodrës, ata që e mbajtën fuqishëm në trojet e Kurbinit, në Mirditë, në Sarandë, në Mallakastër, në Kolonjë e kudo. E vërtetë, kapitalistët na shohin me inat si Zeusi Prometeun, por ata s'do mundin kurrë të na lidhin në shkembejtë e egër të Kaukazit që ndonjë shqiponjë të na hajë mëlçinë. Ne, komunistët, lindëm në këtë botë nga plagët e popujve të pranguar, ne u rritëm në këtë botë për të këputur pranga e tiranive. Ne momentalisht duhet të bëjmë më shumë që jo vetëm të propagandojmë alternativën tonë në

popull, por edhe shokët tanë heronj që nuk mungojnë në radhët tona, prandaj t'i përkushtohemi edhe propagandës dhe emulacionit komunist nëpërmjet gazetës "Zëri i së vërtetës" e gjithëfarë formash, të rritim në shkallën më të lartë frymën shoqërore, ta ndiejmë si tonin gëzimin e shokëve e si tonin edhe hidhërimin e tyre. Rreth nesh ka mjaft njerëz që nuk na duan. Ka prej tyre që shkruajnë kundër nesh libra të modelit "Rrnoj për me tregue", por që në fakt nuk i tregojnë duart dhe ndërgjegjet e shitura. Por ja që edhe ne rrojmë për të treguar se ata për 50 vjet, që nga viti 1870 deri më 1919 u shërbyen tradhëtisht austro-hungarezëve; që nga viti 1919 deri më 1943, për 24 vjet me radhë, u shërbyen tradhëtisht italianëve, që nga viti 1943 deri më 1944 u shërbyen gjermanëve, që nga viti 1944 u vunë në shërbim të agjenturave të huaja, duke shënuar kështu nja 100 vjet tradhëti, të cilën e vijonë edhe sot në mënyra të ndryshme sipas rrethanave të ndryshme. Rreth nesh ka mjaft popull që na do e do të na dojë akoma më shumë ky popull kur t'u gjendemi pranë të varfërve. Dhe të mos harrojmë: të varfër ka edhe në krahun rozë, edhe në krahun blu. Ne nuk paragjykojmë ngjyrat ku të varfërit kanë rënë viktimë. Ne e shohim popullin pa syze ngjyrash. Ne e duam atë të tërin. Nuk duam vetëm armiqtë e tij. Rreth nesh ndër shtete e kontinente kemi miliona vëllezër komunistë e demokratë përparimtarë. Sot në botë funksionojnë mbi gjashtëqind parti e organizata komuniste dhe mijëra e mijëra grupime antikapitaliste. Me ta mund të kemi edhe mendime të kundërta, por bashkohemi në çka na bashkon e ndahemi në çka na ndanë. Propaganda jonë do pasqyrojë vijën politike të Partisë në planin e brendshëm e të jashtëm. Ne kemi qenë e mbetemi për internacionalizmin proletar. Ne kemi qenë e mbetemi partizanë të paqes në botë. Ne kemi qenë e mbetemi kundër luftërave grabitqare dhe nuk besojmë në "demokracinë" nën grykën e topave. Ne kemi qenë e mbetemi kundër dërgimit të bijve shqiptarë në popuj të tjerë, siç ka ndodhur dërgimi i tyre në Irak apo Afganistan. Ne kemi qenë e mbetemi për një Europë e Ballkan pa ushtri të huaja e baza të huaja ushtarake.

Shokë e shoqe,

Përmbysja e socializmit në Shqipëri, apo si sistem botëror më vete, nuk është një fatalitet. Historia njih shumë fitore, përmbysje të tyre e përsëri fitore. Po të hynim disi thellë në histori mund të kujtonim dy revolucione të fituara e pastaj të mundura, e pastaj të fituara. U shtyp kreyengritja e madhe e skllavërisë nën komandën e Spartakut në kohën e Perandorisë Romake që shtrihej pothuaj në gjysmën e botës, u vranë e u masakruan të gjithë luftëtarët e Spartakut, por nuk e vra dot ëndrra e skllavëve për të fituar mbi skllavopronarët. U shtyp kryengritja e madhe e fshatarëve francezë të shekullit të 14-të kundër feudalizmit, u shtypën lëvizjet e mëdha të armatosura po këtë shekull në Çeki, por ideja për rrëzimin e feudalizmit mbeti gjallë. Shpërthyen revolucionet borgjezë në Angli në shekullin e 17-të dhe në Francë në shekullin e 18-të, të cilat ranë pas një kohe. Në Angli u rikthye sërisht dinastia mbretërore e stjuartëve dhe liderit të revolucionit, Kromuellit, i humbën edhe eshtrat, por prap idetë iluministe mbetën gjallë. U rrëzua edhe revolucioni francez, më i madhi në kushtet e sistemi feudal, por idetë e Zhan Zhak Rusoit e tërë asj plejade që i prinë këtij revolucioni mbetën gjallë dhe mbi feudalizimin triumfoi një rend më i përparuar për kohën, ai kapitalist. Por as kapitalizmi që doli në skenë si sistem i vetëm botëror nuk do të mbetej i vetëm. Kështu kanë rrjedhur ngjarjet, deri kur 170 vjet më parë dy kapitenët më të mëdhenj të njerëzimit, Marksi dhe Engelsi, paralajmëruan njerëzimin se ajo "fantazma" që endet nëpër Europë "fantazma e komunizmit" shumë shpejt do të bëhej realitet, sepse kapitalizmi nuk mund të ishte një rend i përjetshëm. Vetëm pas 20 vjetësh, të frymëzuar nga idetë shpëtimtare të Manifestit Komunist, parisienët u hodhën në revolucionin e parë proletar dhe të rreshtuar ndër barrikatat e Komunës së Parisit "sulmuan qiejt". Komuna vërtetë e shtyp me zjarr e me

hekur, por idetë e saj mbetën të gjalla në shpirtin e njerëzimit deri në ditën që triumfoi Revolucioni i madh i Tetorit në Rusi dhe pas Luftës së Dytë Botërore socializmi doli si sistem botëror më vete. Imperialistët dhe gjithë mercenarët e ideologjisë borgjeze e paraqesin këtë përmbysje si dështim të socializmit, por e vërteta qëndron krejt ndryshe. Rënia e socializmit jo vetëm nuk i mbylli plagët e vjetra kapitaliste, përkundrazi ato janë zmadhuar në pakufi. Një zemërim ndërplanetar po shpërthen në dhjetra shtete të botës. Mes këtij zemërimi të paparë nëpër protestat e qytetarëve francezë ndihen zëra për të përmbysur sistemin e kapitalizmit. Në këto rrethana që po kalon bota një rol të madh ka faktori subjektiv, që nesër në harmoni me faktorin objektiv ta kalojë Europën e gradualisht mbarë botën në socializëm. Gjermania naziste e viteve tridhjetë, e fuqishme ekonomikisht dhe ushtarakisht mori pësisht të pushtonte mbarë Europën për të vendosur nazizmin e nuk mundi. Gjermania e ditëve tona, duket se ka marrë përsipër të shpëtojë Europën e Bashkuar nga kriza, mbështetur në fuqinë e saj ekonomike, por do ta këtë të pamundur. Në këtë situatë komunistët shqiptarë e kanë në mision dhe interesi i Atdheut e kërkon që ta luajnë atë.

Nuk është koha për të numëruar yjet, por është koha për të “sulmuar qiej”. Mos na mungon forca e guximi? Edhe në na mungofshin, duhet t’i kërkojmë ku të jenë. Në vitin dyzetekatër në Selanik, ka ndodhur një epope. Gjermanët patën ngritur një podium në mes të qytetit me një trikëmbësh mbi të. Ata e detyruan popullin e Selanikut me forcën e armëve të mbledheshin para atij podiumi. Çuan aty edhe një numër shqiptarësh që do t’i nisnin për Mathauzen. Ra nata e errët. Populli priste të shikonte një ekzekutim special. Prozhektorët ndriçuan podiumin. Pastaj u panë dy xhelatë që po sillnin drejt trekëmbëshit personin që do të ekzekutohej. Sytë e Selanikut panë se ky person ishte një vajzë e re. Ndërkaq, për të ngjallur sa më tepër tmerr e frikë, gjëmuan sirenat. Por për mes tmerrit të sirenave vajza e torturuar barbarisht mblodhi energjitë për t’u treguar nazistëve gjermanë dhe popullit të Selanikut se ishte më e fortë se Olimpi dhe mblodhi tërë fuqitë dhe buçiti krenare zërin e saj. Dhe ç’të dëgjoje! **Ajo fliste në gjuhën shqipe:** “Vdeje nazizmit, liri popujve! Jam shqiptare! Ne do të fitojmë! Rroftë Shqipëria! Rroftë PKSH!” Ndërsa grekët e befasuar shpërthyen në gjuhën e tyre “Allvaniko, allvaniko”, qindra shqiptarë që do të shkonin në Mathauzen shpërthyen në lot, por dhe u ndien krenarë që një vajzë partizane shqiptare, vetëm 17 vjeçe, e quajtur Fato Berberi shkante drejt litarit madhështore si heronjtë homerikë. Mos vallë të gjithë së bashku, qindra burra e gra komuniste, s’paskemi aq fuqi e guxim sa Fato Berberi për t’u hedhur në barrikadat e luftës klasore me britmën “Vdekje kapitalizmit, socializëm popullit”? Po, e kemi, nëqoftëse ngjizet bashkë çeliku i vullneteve tona, nëqoftëse e duam ëndrrën tonë dhe manifestojmë gatishmërinë tonë heroike për realizimin e saj. Prandaj në emër të atyre që u torturuan në kuesturat fashiste e Gestapos gjermane, në emër të atyre që ranë heroikisht me ëndrrën e çlirimit kombëtar e shoqëror në fushat e betejave, në emër të punëtorëve dhe fshatarëve që derdhën lumenj djerse për ndërtimin e Shqipërisë së re, në emër të amanetit të shokut Enver Hoxha për ta mbajtur Shqipërinë të kuqe, në emër të shokëve tanë të vdekur e të gjallë, që sakrifikuan si askush shqiptar tjetër në këto 20 vjet për ta mbajtur të ndezur zjarrin e idealeve komuniste, të bëjmë më të mirën të mundshme për realizimin e detyrave tona dhe vënien e dinjitetit të Partisë Komuniste në piedestalin e merituar në të mirë të popullit e të Atdheut.

Rroftë Partia Komuniste e Shqipërisë!

Lavdi jetës dhe veprës së shokut Enver Hoxha!

Lavdi Marksizëm-Leninizmit!

Botuar në “Zëri i së vërtetës” – Organ Qendror i Partisë Komuniste të Shqipërisë – Nr. 442 e
shtunë 24 dhjetor 2011